



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 32 (827988)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 gusht 2026



PËRPARA FLAKËVE, PËRPARA RREZIKUT USHTRIA NË MBROJTJE TË SHQIPËRISË

» faqe 4



MIRËNJOHJE PËR PILOTËT E FORCËS AJRORE NË SHËRBBIM TË VENDIT!

Ministri i Mbrojtjes Erman Nuri dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësojnë përkushtimin e ekuipazheve në operacionet kundër zjarreve.

Në një prej periudhave më intensive të angazhimit të Forcave të Armatosura në përballimin e situatës së zjarreve, ministri i Mbrojtjes, Erman Nuri, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, kanë shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin për pilotët dhe ekuipazhet e Forcës Ajrore...

faqe 2



FORCAT E ARMATOSURA NË VIJËN E PARË TË PËRBALLIMIT TË ZJARREVE NË VEND

Prej orëve të para të mëngjesit, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë vijuar me intensitet të lartë angazhimin në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në disa zona të vendit. Efektivët e Forcës Tokësore dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura janë vendosur në terren në mbështetje të autoriteteve civile, duke ndërhyrë në vatrat aktive dhe duke kontribuar në mbrojtjen e komuniteteve, banesave, bizneseve dhe mjedisit. Operacionet janë zhvilluar në koordinim të plotë me strukturat vendore...

faqe 3



MELODIA E FORCËS AJRORE: SI I MENAXHON KRYEKAPTER AIDA GUXHA, FLAUTIN, KËNGËN DHE LIDERSHIPIN USHTARAK

Sfidat dhe Triumfet e Gruas në Uniformë. Sot, imazhi i Forcave të Armatosura nuk mund të imagjinohet pa kontributin e paçmuar të personelit femëror. Nga zyrtat e logjistikës e deri në kabinat e helikopterëve apo në misione paqeruajtëse, gratë dhe vajzat në uniformë kanë dëshmuar se profesionalizmi, guximi dhe devotshmëria nuk njohin gjini. Të ndërtosh një karrierë të tillë si femër në një...

faqe 8

Mirënjohje për pilotët e Forcës Ajrore në shërbim të vendit!

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nuçi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralletënant Arben Kingji, vlerësojnë përkushtimin e ekuipazheve në operacionet kundër zjarreve

Në një prej periudhave më intensive të angazhimit të Forcave të Armatosura në përballimin e situatës së zjarreve, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nuçi, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant Arben Kingji, kanë shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin për pilotët dhe ekuipazhet e Forcës Ajrore, të cilët prej ditësh vijojnë të jenë në ajër në shërbim të qytetarëve dhe të vendit.

Në kushte të vështira atmosferike dhe operacionale, efektivët e Forcës Ajrore janë angazhuar në misione të njëpasnjëshme për mbështetjen e operacioneve tokësore kundër zjarreve. Përmes ndërhyrjeve nga ajri, ata kanë kontribuar në izolimin dhe neutralizimin e vatrave më problematike, duke ndihmuar në kufizimin e përhapjes së flakëve drejt zonave të banuara dhe në mbrojtjen e pasurive natyrore.

Në ajër për çdo mision

Misionet e Forcës Ajrore janë zhvilluar në koordinim të ngushtë me strukturat operacionale në terren. Avionët dhe helikopterët janë përdorur për ndërhyrje në zonat ku terreni i vështirë dhe shtrirja e vatrave e kanë bërë të domosdoshme mbështetjen ajrore.

Çdo dalje në mision kërkon përgatitje të kujdesshme, koordinim të vazhdueshëm dhe profesionalizëm maksimal të ekuipazheve. Pilotët e Forcës Ajrore kanë vijuar të kryejnë detyrën e tyre me përkushtim, duke u përballur me kushtet e vështira të operimit dhe duke vënë në dispozicion aftësitë dhe përvojën e tyre në funksion të sigurisë së qytetarëve.

Në këtë situatë, kontributi i tyre është bërë pjesë e pandashme e përpjekjes së përbashkët të Forcave të Armatosura dhe strukturave civile për menaxhimin e emergjencave.

Vlerësim për përkushtimin dhe sakrificën

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nuçi, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralletënant Arben Kingji, kanë përcjellë një mesazh të veçantë mirënjohjeje për të gjithë pilotët dhe ekuipazhet që po shërbejnë në këto ditë të vështira.

“Mirënjohje për pilotët e Forcës Ajrore, që këto ditë janë në ajër në shërbim të vendit, duke u përballur me zjarret dhe duke mbrojtur jetën, pronën dhe pasuritë tona natyrore.



Faleminderit për çdo mision, përkushtim dhe sakrificë!”.

Ky vlerësim shkon për çdo efektiv të Forcës Ajrore që, larg familjeve dhe në kushte të vështira pune, vijon të jetë në gatishmëri për të përbushur çdo detyrë të ngarkuar.

Një ekip i vetëm në mbrojtje të qytetarëve

Operacionet kundër zjarreve janë një përpjekje e përbashkët, ku ndërthuren kapacitetet ajrore dhe tokësore të Forcave të Armatosura me strukturat e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Policinë e Shtetit, strukturat e emergjencave civile, pushtetin vendor dhe aktorë të tjerë të angazhuar në terren.

Në këtë zinxhir operativ, Forca Ajrore ka një rol të



rëndësishëm në mbështetjen nga ajri, veçanërisht në zonat ku ndërhyrja tokësore është e vështirë dhe ku kërkohet reagim i shpejtë.

Profesionalizmi i pilotëve, koordinimi me ekipet në tokë dhe gatishmëria për të kryer misionet në çdo moment janë elementë thelbësorë për suksesin e operacioneve.

Për Forcat e Armatosura, çdo mision është një detyrë në shërbim të qytetarëve. Në tokë dhe në ajër, efektivët vijojnë të jenë të gatshëm për të ndërhyrë aty ku kërkohet mbështetja e tyre.

Respekt dhe mirënjohje për pilotët dhe të gjithë efektivët e Forcës Ajrore që, me profesionalizëm, guxim dhe sakrificë, janë çdo ditë në shërbim të vendit!

Komanda Mbështetëse vijon angazhimin në luftën kundër zjarreve

Efektivët e Forcave të Armatosura vijojnë prej ditësh të jenë të angazhuar në përballimin e situatës së zjarreve në territorin e Bashkisë Krujë.

Strukturat kryesore të angazhuara në përballimin e emergjencave civile po ndërhyjnë në terren për izolimin dhe shuarjen e plotë të vatrave të zjarrit, duke punuar në kushte të vështira dhe në koordinim me strukturat e tjera përgjegjëse.

Komanda Mbështetëse, përmes kapaciteteve të saj operacionale dhe efektivëve të angazhuar në terren, vijon të garantojë gatishmërinë dhe ndërhyrjen në çdo situatë emergjente, me prioritet mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit. Angazhimi i Forcave të Armatosura do të vijojë deri në përfundimin e plotë të operacioneve dhe normalizimin e situatës.



FORCA AJRORE NË FRONTIN E MBROJTJES CIVILE

Teknologjia UAV, një sy në qiell për monitorimin e zjarreve në të gjithë territorin e Shqipërisë

Në kushtet e situatës së rënduar të krijuar nga zjarret në disa zona të vendit, Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë ka intensifikuar angazhimin e saj në mbështetje të strukturave të mbrojtjes civile, duke vënë në dispozicion teknologjinë, kapacitetet operacionale dhe ekspertizën profesionale.

Në ditët e fundit, monitorimi ajror me mjete ajrore pa pilot (UAV) është shtuar ndjeshëm mbi zonat e prekura nga zjarret, duke përfshirë Mallakastrën, Dajtin në Tiranë, Krujën dhe Lurën. Vëzhgimi ajror shtrihet, sipas nevojës dhe situatës operacionale, në zona të ndryshme të territorit të vendit. Në këtë mision është angazhuar Detashmenti UAV i Forcës Ajrore, i cili, përmes mjeteve ajrore pa pilot “Bayraktar” TB2, siguron informacion dhe pamje nga ajri mbi situatën në terren. Teknologjia e përdorur mundëson një vëzhgim të vazhdueshëm të vatrave të zjarrit, duke ndihmuar në evidentimin e përhapjes së tyre dhe në ndjekjen e dinamikës së situatës.

Një element i rëndësishëm i këtij monitorimi është edhe vëzhgimi i hapësirës ajrore gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve, përfshirë ndjekjen e lëvizjes së helikopterëve të angazhuar në ndërhyrje.

Ky informacion kontribuon në rritjen e sigurisë dhe në koordinimin më të mirë të veprimeve në terren dhe në ajër.

Të dhënat e mbledhura nga ajri përbëjnë një element të rëndësishëm për strukturat përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave.

Pamjet dhe informacioni i siguruar në kohë reale ndihmojnë në krijimin e një panorame më të qartë të situatës, në përcaktimin e zonave ku kërkohet ndërhyrje dhe në orientimin e forcave dhe mjeteve



drejt vatrave me prioritet.

Përdorimi i teknologjisë moderne në operacionet e mbrojtjes civile tregon se kapacitetet e Forcave të Armatosura nuk kufizohen vetëm në misionet tradicionale të mbrojtjes dhe sigurisë. Ato janë gjithnjë e më shumë një komponent i rëndësishëm i reagimit kombëtar ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Në këtë kuadër, kapacitetet e Forcës Ajrore marrin një rëndësi të veçantë. Aftësia për të vëzhguar zona të gjera nga ajri, për të identifikuar ndryshimet në terren dhe për të përcjellë informacionin tek strukturat përgjegjëse krijon një avantazh të rëndësishëm në menaxhimin e situatave emergjente.

Nga qielli, çdo vatër zjarri bëhet pjesë e një harte të madhe operacionale. Informacioni i marrë nga UAV-të

ndihmon strukturat në terren të kuptojnë më mirë drejtimin e përhapjes së zjarrit, të vlerësojnë situatën dhe të përshtatin ndërhyrjen në varësi të zhvillimeve.

Angazhimi i Forcës Ajrore në këto operacione është një tjetër dëshmi e rolit të Forcave të Armatosura në mbështetje të komuniteteve dhe institucioneve civile në situata të emergjencës.

Në një kohë kur zjarret përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, banesat, infrastrukturën dhe pasuritë natyrore të vendit, syri i teknologjisë nga ajri bëhet një instrument i rëndësishëm për reagimin e shpejtë dhe të koordinuar.

Forca Ajrore vijon të qëndrojë në gatishmëri, duke vënë në shërbim të mbrojtjes civile teknologjinë moderne, kapacitetet e saj operacionale dhe profesionalizmin e personelit, me një objektiv të qartë: mbrojtjen e jetës, pronës, territorit dhe pasurive natyrore të Shqipërisë.

Në tokë luftohet me zjarrin; nga ajri, teknologjia ndihmon për ta parë, ndjekur dhe orientuar më mirë luftën kundër tij.

Prej orëve të para të mëngjesit, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë vijuar me intensitet të lartë angazhimin në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në disa zona të vendit. Efektivët e Forcës Tokësore dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura janë vendosur në terren në mbështetje të autoriteteve civile, duke ndërhyrë në vatrat aktive dhe duke kontribuar në mbrojtjen e komuniteteve, banesave, bizneseve dhe mjedisit. Operacionet janë zhvilluar në koordinim të plotë me strukturat vendore të emergjencave, Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, Policinë e Shtetit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, strukturat e mbrojtjes së zonave të mbrojtura, shërbimin pyjor, strukturat bashkiake dhe vullnetarët. Ndërhyrja e përbashkët, nga toka dhe ajri, ka pasur si objektiv kryesor izolimin e vatrave, kufizimin e përhapjes së flakëve dhe parandalimin e çdo rreziku për zonat e banuara.



Forca Tokësore, angazhim në disa fronte
Në operacionet e zhvilluara gjatë ditës, Regjimenti i Këmbësoresisë së Jugut ka angazhuar 60 efektivë dhe automjete zjarrfikëse në fshatin Badonjë, në Bashkinë Përmet, si dhe në zonën e Drenies, Bashkia Patos. Në veri të vendit, Regjimenti i Këmbësoresisë së Veriut ka angazhuar 53 efektivë, të pajisur me mjete dhe pajisje zjarrfikëse, në operacionin për përballimin e situatës në Lurë. Forcat e angazhuara në terren kanë punuar në kushte të vështira, duke ndërhyrë në zona me terren të thyer dhe në vatra të shtrira në masive pyjore. Puna e tyre është fokusuar në krijimin e vijave të izolimit, neutralizimin e vatrave dhe parandalimin e përhapjes së flakëve drejt zonave të banuara. Forca Tokësore ka vijuar të mbetet në gatishmëri të plotë për të ndërhyrë në mbështetje të autoriteteve civile dhe komuniteteve të prekura, kudo ku situata e ka kërkuar.

Lurë, operacion intensiv nga toka dhe ajri
Një prej vatrave ku operacioni ka vijuar me intensitet të lartë është Parku Kombëtar i Lurës, në zonën e Runjës, mbi fshatin Borie Lurë. Në këtë zonë janë angazhuar rreth 220 forca dhe efektivë nga strukturat e MZSH-së, Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, ADZM, shërbimi pyjor, strukturat bashkiake, vullnetarë, AKMC dhe Prefektura e Qarkut Dibër. Operacioni është zhvilluar në koordinim të plotë nga toka dhe ajri, me prioritet mbrojtjen e banesave dhe kufizimin e përhapjes së zjarrit në territorin e parkut kombëtar. Nga ajri, dy avionë **“Air Tractor”** janë përqendruar në vatrat më problematike, duke mbështetur forcat tokësore në përpjekjet për izolimin dhe neutralizimin e zjarrit. Angazhimi i strukturave vijon deri në vënien plotësisht nën kontroll dhe neutralizimin e vatrës.



FORCAT E ARMATOSURA NË VIJËN E PARË TË PËRBALLIMIT TË ZJARREVE NË VEND

Angazhim maksimal nga toka dhe ajri për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit



Drenie, ndërhyrje e koordinuar nga toka dhe ajri
Në Drenie, Bashkia Patos, riaktivizimi i një vatre zjarri në thellësi të masivit pyjor solli angazhimin e forcave operacionale nga toka dhe të dy avionëve **“Air Tractor”** nga ajri. Ndërhyrja e koordinuar është përqendruar në izolimin e vatrës dhe neutralizimin e saj, duke synuar parandalimin e përhapjes së mëtejshme të zjarrit në masivin pyjor.



Bashkërendimi i kapaciteteve tokësore dhe ajrore ka qenë një element i rëndësishëm i operacionit, veçanërisht në zonat ku terreni e vështirëson ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të mjeteve zjarrfikëse.

Krujë, situata nën monitorim të vazhdueshëm
Në kushtet e një situatë të vështirë në zonën e Abazes, në Krujë, Forcat e Armatosura janë angazhuar në terren në mbështetje të operacionit për përballimin e flakëve dhe mbrojtjen e banorëve dhe pronës. Efektivët kanë punuar krah për krah me strukturat e tjera të emergjencave, duke u përqendruar në frenimin e



përhapjes së zjarrit dhe mbajtjen nën kontroll të situatës. Në Krastë dhe në fshatin Halil, ndërhyrja e dy helikopterëve, në bashkëpunim me forcat operacionale në terren, ka sjellë përmirësim të ndjeshëm të situatës. Puna

ka vijuar për izolimin dhe shuarjen e plotë të vatrave, me prioritet mbrojtjen e banesave dhe komunitetit. Në fshatin Halil, rreziku i përhapjes së zjarrit drejt zonave të banuara është kapërcyer. Megjithatë, forcat dhe mjetet operacionale kanë vijuar të qëndrojnë në zonë gjatë natës, në gatishmëri të plotë për çdo situatë dhe për ndërhyrje të menjëhershme në rast të riaktivizimit të vatrave.

Në gatishmëri për çdo situatë
Në të gjitha zonat ku janë evidentuar vatra zjarri vijon monitorimi i pandërprerë i situatës. Sipas vlerësimit operacional të përcjellë gjatë zhvillimit të operacioneve, vatrat aktive janë mbajtur nën kontroll dhe nuk është evidentuar rrezik i drejtpërdrejtë për jetën e qytetarëve dhe zonat e banuara.

Nga Kruja në Lurë, nga Drenie e Patosit deri në zonat e tjera të prekura, efektivët e Forcave të Armatosura kanë qenë në vijën e parë të përballimit të situatës, në mbështetje të komuniteteve dhe strukturave civile. Puna e tyre është karakterizuar nga gatishmëria, koordinimi dhe përkushtimi përballë një situatë dinamike, ku riaktivizimi i vatrave dhe kushtet e terrenit kërkojnë monitorim dhe ndërhyrje të vazhdueshme. Forcat e Armatosura mbeten të gatshme për të vënë në dispozicion kapacitetet e tyre njerëzore, tokësore dhe ajrore në çdo rast kur kërkohet mbështetja e autoriteteve civile.

Mirënjohje për efektivët në terren
Në çdo operacion, përtej mjeteve dhe kapaciteteve të angazhuara, janë njerëzit ata që përballen drejtpërdrejt me vështirësitë e terrenit dhe rrezikun e flakëve. Efektivët e Forcave të Armatosura, së bashku me të gjithë strukturat e angazhuara në operacionet e emergjencave civile, kanë dëshmuar edhe një herë gatishmërinë dhe përgjegjshmërinë e tyre në shërbim të qytetarëve. Puna e përbashkët e MZSH-së, Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, strukturave të mbrojtjes civile, shërbimit pyjor, strukturave vendore dhe vullnetarëve ka bërë të mundur menaxhimin e situatës në disa prej zonave më të prekura. Në vijën e parë, efektivët vijnë në jenë krah qytetarëve, duke mbrojtur jetën, pronën, bizneset dhe pasuritë natyrore të vendit.

Apel për kujdes dhe përgjegjshmëri
Në kushtet e temperaturave të larta dhe rrezikut të shtuar për përhapjen e zjarreve, apeli për qytetarët mbetet i qartë: **kujdes, vigjilencë dhe përgjegjshmëri**. Parandalimi i zjarreve dhe raportimi në kohë i çdo vatre janë thelbësore për shmangien e pasojave dhe mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit. Forcat e Armatosura do të vijnë në jenë në gatishmëri dhe të ndërhyjnë në mbështetje të strukturave civile, me të njëjtin objektiv: **mbrojtjen e qytetarëve dhe përballimin sa më efektiv të çdo situatë emergjente**.

Bashkëpunim në fushën e arsimit ushtarak: Akademia e Forcave të Armatosura, vizitë në Akademinë Ushtarake “G.S. Rakovski”

Akademia Ushtarake “G.S. Rakovski” në Bullgari priti një delegacion të Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e arsimit dhe formimit ushtarak. Gjatë vizitës, përfaqësuesit e të dy institucioneve prezantuan historikun, misionin, strukturën dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së tyre. Në diskutime u vlerësua rëndësia që kanë këto institucione në përgatitjen dhe formimin e kuadrove për sistemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së dy vendeve. Takimet u përqendruan në çështje aktuale që lidhen me zhvillimin e arsimit ushtarak, përmirësimin e programeve të përgatitjes së oficerëve, përshtatjen e praktikave moderne arsimore, si dhe nxitjen e kërkimit shkencor. Një vëmendje e veçantë iu kushtua mundësive për zgjerimin e shkëmbimeve akademike, ndarjen e praktikave më të mira dhe thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet dy institucioneve. Në kuadër të programit të vizitës, delegacioni shqiptar



u njoh edhe me disa prej atraksioneve kulturore dhe historike të Akademisë Ushtarake “G.S. Rakovski”, ndër të cilat edhe kompleksi “Sallat e Carit”. Trashëgimia e pasur historike e këtij kompleksi dhe vendi i tij i rëndësishëm në historinë e arsimit ushtarak bullgar përbënë një tjetër pikë



të veçantë të vizitës. Shkëmbime të tilla kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve institucionale, në ndarjen e përvojave dhe në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit ushtarak, në funksion të përgatitjes së brezave të rinj të drejtuesve ushtarakë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në vijën e parë të flakëve nuk ka kamera, nuk ka podiume dhe nuk ka duartrokitje. Ka vetëm uniforma, tym, nxehtësi dhe një betim: të mbrosh jetën.

Ka momente kur një vend matet jo me fjalët që thotë, por me njerëzit që nxjerr në front kur gjithçka bëhet e vështirë.

Ka ditë kur Shqipëria nuk ka nevojë për fjalime, por për duar që hapin rrugën mes flakëve, për njerëz që hyjnë në tym kur të tjerët largohen, për helikopterë që ngrihen drejt qiellit kur toka poshtë tyre digjet dhe për ushtarakë që nuk pyesin sa orë kanë në këmbë, por sa metra zjarr kanë ende përpara.

Janë ditë si këto.

Vera ka veshur sërish vendin me ngjyrën e rrezikut. Temperaturat, thatësira, era dhe terrenet e vështira e kanë kthyer zjarrin në një kërcënim që nuk njeh kufij bashkie, qarku apo fshati. Në ditët e fundit janë raportuar dhjetëra vatra zjarri, disa prej tyre aktive, ndërsa strukturat e mbrojtjes civile kanë vijuar operacionet në terren.

Dhe në këtë panoramë të rënduar, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë sërish aty ku kërkohet më shumë guxim: në vijën e parë.

Jo pas flakëve.

Përpara tyre.

USHTARI QË NUK PYET SA E MADHE ËSHTË FLAKA

Ne jemi mësuar ta shohim ushtarin në uniformë, me armë, në stërvitje, në kufi, në misione ndërkombëtare, në ceremonialet shtetërore.

Por ka një tjetër fytyrë të uniformës.

Është ajo që shfaqet kur vendi përballlet me një fatkeqësi natyrore.

Është ushtari që lë armën në krah dhe merr mjetet për të hapur një korridor mbrojtës.

Është ai që ecën në terren të thyer, me maskën e fytyrës të mbuluar nga tymi.

Është ai që punon me orë të tëra nën një temperaturë që e bën edhe ajrin të vështirë për t'u marrë frymë.

Është ai që nuk ka luksin të presë që rreziku të kalojë.

Sepse detyra e tij është të hyjë aty ku rreziku është.

Në Krastë të Krujës, dhjetëra efektivë të Forcave të Armatosura vijuan operacionin për izolimin e zjarrit. Është vetëm një nga shumë frontet ku uniforma ushtarake është vendosur përballë një armiku që nuk ka fytyrë, por ka forcën për të shkatërruar pyje, banesa, toka dhe kujtime të tëra.

Ky është një tjetër lloj luftimi.

Armiku nuk ka flamur.

Nuk ka ushtri.

Nuk ka komandant.

Ka erë, temperaturë, thatësi dhe flakë.



PËRPARA FLAKËVE, PËRPARA RREZIKUT – USHTRIA NË MBROJTJE TË SHQIPËRISË



Dhe pikërisht për këtë arsye, kjo luftë është ndër më të paparashikueshmet.

NJË FRONT KU FITORJA ËSHTË NJË SHTËPI QË NUK DIGJET

Në një operacion ushtarak, fitorja mund të matet me objektiva të marrë, me terren të kontrolluar, me një mision të përfunduar.

Në luftën kundër zjarreve, fitorja është shumë më njerëzore.

Është një shtëpi që mbetet në këmbë.

Është një familje që nuk evakuohet. Është një pyll që shpëton.

Është një kafshë që nxirret nga zona e rrezikut. Është një rrugë që mbetet e hapur. Është një i moshuar që largohet në kohë nga banesa.

Është një fëmijë që nuk sheh shtëpinë e tij të kthehet në hi.

Këto janë fitoret e heshtura të atyre që luftojnë me flakët.

Dhe ndoshta pikërisht sepse janë të heshtura, ne nuk i shohim gjithmonë.

Kamera ndalet te flaka.

Por pas kamerës është njeriu. Njeriu me uniformë.



KUR UNIFORMËN E NJOHIM MË SHUMË -NË DITËT E RREZIKUT

Forcat e Armatosura nuk janë vetëm një strukturë e mbrojtjes kombëtare në kuptimin klasik të fjalës. Në një shtet modern, ushtria është gjithashtu një kapacitet strategjik për përballimin e krizave.

Kur natyra godet, shteti duhet të jetë në gjendje të reagojë shpejt, të organizojë burimet, të transportojë njerëz dhe pajisje, të ndërtojë korridore, të sigurojë logjistikën dhe të ndërhyjë në terrene ku mjetet civile shpesh e kanë të pamundur të veprojnë.

Këtu hyn përvoja, disiplinimi dhe struktura komanduese e Forcave të Armatosura. Por përtej strukturës është njeriu.

Dhe njeriu është gjithmonë pika ku fillon sakrifica.

Një ushtar nuk është makinë.

Ai lodhet.

Ka etje.

Ka familje.

Ka fëmijë.





Ka frikë.
Por ka edhe një gjë që e dallon, detyrimin.
Kur thirrja vjen, ai ngrihet. Kur urdhri jepet, ai niset. Kur flaka përparon, ai nuk pyet nëse është momenti i duhur.
Ai shkon.

PILOTËT QË SHOHIN ZJARRIN NGA QIELLI

Në tokë lufta me flakën është brutale.
Nga ajri është ndryshe.
Më e shpejtë. Më e rrezikshme. Më e pamëshirshme. Çdo fluturim mbi një zonë të përfshirë nga zjarri kërkon përqendrim maksimal.
Poshtë është terreni i përflakur; përpara është tymi, ajri është i paqëndrueshëm; era mund të ndryshojë drejtim dhe në pak sekonda një situatë e kontrolluar mund të kthehet në rrezik. Helikopterët e Forcave të Armatosura janë bërë ndër vite një nga simbolet më të dukshme të ndërhyrjes së shtetit në këto situata.

Nga qielli, piloti nuk sheh vetëm një vatër. Sheh një hartë të gjallë të rrezikut. Një flakë që lëviz. Një vijë që duhet ndalur. Një zonë të banuar që duhet mbrojtur.
Dhe pas çdo manovre të tij është një ekip në tokë që pret që ndërhyrja nga ajri t’u japë atyre mundësinë për të fituar terren.
Është një operacion ku toka dhe qielli punojnë si një trup i vetëm.

HERONJTË PA EMËR

Ka diçka të padrejtë në mënyrën se si harrojmë shpejt. Kur zjarri fiket, kur tymi largohet, kur rrugët pastrohen dhe lajmet kalojnë te një temë tjetër, ata që ishin në terren kthehen në repartet e tyre. Uniforma pastrohet. Mjetet mirëmbahen.
Pajisjet vendosen në vend. Por lodhja mbetet. Edhe kujtimi i atyre orëve.
Ndoshta një nga plagët më të mëdha të shoqërisë moderne është se ajo e konsumon heroizmin shumë shpejt. Sot i quajmë heronj. Nesër i harrojmë.



Prandaj gazeta “Ushtria” ka një detyrë më të madhe se raportimi i një operacioni. Ka detyrën e kujtesës. Të shkruajë emrat e njerëzve që ndoshta nuk do t’i kërkojnë kurrë vetë. Të tregojë historitë që nuk hyjnë gjithmonë në kronikat e ditës. Të kujtojë se pas një fotografie me uniformë, helmetë, kazmë, pompë uji apo zorë zjarrfikëse, qëndron një njeri.
Një shqiptar.
Një ushtar.
Një prind.
Një bir.
Një bashkëshort.
Një qytetar që në atë moment ka zgjedhur të mbrojë qytetarët e tjerë.



NUK ËSHTË VETËM NJË BETEJË ME ZJARRIN

Në këto ditë, duhet thënë edhe diçka tjetër.
Zjarri nuk është vetëm një problem i emergjencave. Është një provë për shtetin. Është një provë për organizimin. Është një provë për kapacitetet tona. Është një provë për ndërgjegjen qytetare. Sepse asnjë ushtri, sado e përgatitur të jetë, nuk mund ta fitojë e vetme

luftën kundër zjarreve.
Forcat e Armatosura, zjarrfikësit, policia, strukturat e mbrojtjes civile, pushteti vendor dhe komunitetet duhet të funksionojnë si një sistem i vetëm. Dhe pikërisht koordinimi është ajo që e shndërron reagimin e shpërndarë në një mbrojtje kombëtare.
Në situatën e fundit, autoritetet kanë raportuar se Forcat e Armatosura vijnë angazhimin në terren, në koordinim me strukturat e tjera të emergjencave.
Ky bashkëpunim nuk është luks. Është domosdoshmëri.
Sepse zjarri nuk pret burokracinë. Nuk pret mbledhjet. Nuk pret procedurat e gjata.
Ai ecën.
Dhe shteti duhet të ecë më shpejt.

ATA QË HYJNË ATJE KU NE IKIM

Ka një moment të veçantë në çdo fatkeqësi. Momenti kur shumica kërkon të largohet.
Dhe dikush tjetër duhet të shkojë drejt rrezikut.
Ky është momenti kur kuptohet çfarë do të thotë uniforma. Kur qytetari largohet nga zjarri, ushtari afrohet.
Kur familja kërkon një rrugë shpëtimi, ushtari ndihmon në hapjen e saj. Kur terreni bëhet i pakalueshëm, ushtari kërkon një tjetër rrugë.
Kur nata e bën flakën edhe më të frikshme, ai qëndron. Nuk ka asgjë romantike në këtë.
Ka vetëm përgjegjësi.
Sepse heroizmi i vërtetë nuk është të mos kesh frikë. Është të vazhdosh edhe kur e di se rreziku ekziston.

NJË MIRËNJOHJE QË NUK DUHET TË MBETET VETËM FJALË

Shqipëria u detyrohet shumë këtyre njerëzve. Por mirënjohja nuk duhet të jetë vetëm një duartrokitje.
Mirënjohja duhet të kthehet në pajisje më të mira. Në trajnime më të specializuara. Në teknologji. Në mjete moderne.

KUR FLAKA SHUHET, MOS I HARRONI ATA QË QËNDRUAN

Ndoshta nesër do të bjerë shi.
Ndoshta toka do të ftohet.
Ndoshta qielli do të pastrohet nga tymi.
Ndoshta lajmet do të flasin për diçka tjetër.
Por atje ku sot ka zjarr, nesër do të mbeten pemët e djegurat, tokat e nxira dhe gjurmët e një vere të vështirë.
Dhe do të mbetet edhe një kujtim.
Kujtimi i atyre që ishin aty.
Në një Shqipëri të mbuluar nga tymi, ata zgjedhën të mos largoheshin.
Në një tokë ku flaka përparonte, ata ecën përpara.
Në një natë ku rreziku dukej më i madh se njeriu, ata treguan se njeriu mund të jetë më i fortë se frika.
Këta janë njerëzit që duhet t’i shohim.
Jo vetëm kur kamera i filmon.
Jo vetëm kur lajmet i përmendin.
Jo vetëm kur një institucion publikon një fotografi.
Duhet t’i shohim si pjesë të një Shqipërie që funksionon në momentet kur ajo ka më shumë nevojë për veten.
Sepse Forcat e Armatosura nuk janë vetëm ata që ruajnë kufijtë. Janë edhe ata që, kur kufiri i fundit mes flakës dhe shtëpisë është vetëm disa metra, dalin përpara.
Dhe e mbrojnë.
Me duar.
Me mjete.
Me disiplinë.
Me guxim.
Me jetë.
Sot, Shqipëria nuk u kërkon ushtarakëve të saj të fitojnë një luftë me një ushtri armike.
U kërkon të fitojnë një betejë me flakën. Dhe ata janë aty. Në vijën e parë. Aty ku nxehësia është më e madhe. Aty ku tymi të pret frymën. Aty ku toka digjet nën këmbë. Aty ku askush nuk shkon për lavdi. Shkojnë sepse kanë një detyrë. Shkojnë sepse kanë një betim. Shkojnë sepse pas zjarrit është dikush që duhet shpëtuar.
Dhe ndoshta ky është përkufizimi më i thjeshtë i heroit. Ai që shkon drejt rrezikut, kur të gjithë të tjerët kanë arsye për t’u larguar.
Për këta njerëz, një falënderim është i vogël. Por është i domosdoshëm.
Faleminderit, bij dhe bija të Forcave të Armatosura!
Kur Shqipëria u përball me flakët, ju nuk qëndruat pas saj. Qëndruat përpara saj.
Dhe aty, në vijën e parë të zjarrit, uniforma juaj u bë edhe një herë mburojë e jetës.



Miqësi në det, bashkëpunim mes Forcave Detare të Shqipërisë dhe Greqisë

***Vizita treditore e anijeve “HS IKARIA” dhe
“HS LESVOS” në Portin e Durrësit, një tjetër hap
në forcimin e bashkëpunimit detar***

Deti Adriatik u bë edhe një herë hapësirë takimi, bashkëpunimi dhe ndërveprimi mes dy forcave detare aleate. Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak, anijet logjistike L-175 “**HS IKARIA**” dhe L-176 “**HS LESVOS**” të Forcës Detare të Greqisë zhvilluan një vizitë treditore në Portin e Durrësit, duke sjellë me vete jo vetëm ekuipazhet dhe kapacitetet e tyre, por edhe frymën e miqësisë e të bashkëpunimit që karakterizon marrëdhëniet mes dy vendeve.

Vizita u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe profesionale, ku krahas aktiviteteve institucionale dhe ushtarake, pati hapësirë edhe për njohjen me kulturën dhe trashëgiminë shqiptare.

Një pritje në Forcën Detare

Forca Detare e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e vendit pritës, siguroi mbështetjen dhe mbarëvajtjen e të gjitha aktiviteteve të planifikuara gjatë qëndrimit të anijeve greke në Durrës.

Një prej momenteve të rëndësishme të vizitës ishte pritja në Komandën e Forcës Detare, ku Komandanti i Forcës Detare, **Kundëradmiral Arsen Mullaj**, priti komandantët e dy anijeve dhe përfaqësues të ekuipazheve.

Takimi shërbeu si një mundësi për shkëmbimin e përvojave, forcimin e marrëdhënieve profesionale dhe përcjelljen e mesazhit të bashkëpunimit të vazhdueshëm mes dy forcave detare.

Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Greqisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë mbështetet në marrëdhënie të konsoliduara, të cilat marrin një dimension të veçantë në hapësirën detare, ku ndërveprimi, komunikimi dhe mirëkuptimi profesional janë thelbësore.

Kur uniforma takon kulturën

Vizita nuk u kufizua vetëm në aspektin ushtarak. Pjesa tjetër e efektivëve të anijeve greke zhvilloi një vizitë kulturore në qytetin e Beratit.

Qyteti i një mbi një dritareve, me historinë, arkitekturën dhe trashëgiminë e tij të pasur, u ofroi miqve grekë mundësinë të njiheshin më nga afër me një pjesë të rëndësishme të kulturës shqiptare.

Kjo pjesë e programit i dha vizitës një dimension njerëzor, duke krijuar mundësi për njohje dhe komunikim përtej kuadrit profesional. Takimet mes efektivëve të dy forcave, shkëmbimi i eksperiencave dhe njohja me traditat e vendeve përkatëse janë pjesë e rëndësishme e ndërtimit të besimit dhe të marrëdhënieve afatgjata.

Nga porti, drejt detit

Pas tri ditësh qëndrimi në Portin e Durrësit, momenti i përcjelljes së anijeve greke u shndërrua në një tjetër mundësi për bashkëpunim operacional.

Anijet L-175 “**HS IKARIA**” dhe L-176 “**HS LESVOS**” u shoqëruan nga anija P-133 “**LISSUS**” e Distriktit Detar Verior.

Por përcjellja nuk ishte thjesht një ndërrim ceremonial. Në det u zhvillua edhe një stërvitje e përbashkët, gjatë së cilës ekuipazhet ushtruan manovra dhe formacione të ndryshme lundrimi e luftimi.

Në hapësirën detare, ku çdo manovër kërkon koordinim të saktë dhe komunikim të vazhdueshëm, ekuipazhet patën mundësinë të testonin ndërveprimin dhe procedurat e përbashkëta. Lëvizjet e koordinuara të anijeve dhe formacionet e zhvilluara gjatë stërvitjes dëshmuuan rëndësinë e përgatitjes së përbashkët dhe të komunikimit profesional.



Deti, një hapësirë bashkëpunimi

Përtej dimensionit të një vizite portuale, prania e anijeve të Forcës Detare të Greqisë në Durrës dhe zhvillimi i stërvitjes së përbashkët përcjellin një mesazh të qartë: bashkëpunimi detar ndërmjet dy vendeve vijon të forcohet.

Vizita krijoi mundësi për ndërveprim në nivele të ndryshme, nga takimet institucionale dhe shkëmbimi i përvojave, te aktivitetet kulturore dhe stërvitja në det.

Për efektivët shqiptarë dhe grekë, këto kontakte janë një mundësi për të njohur më mirë mënyrën e punës së njëri-tjetrit, për të ndarë përvojat dhe për të rritur nivelin e ndërveprimit.

Në fund të stërvitjes, anijet vazhduan lundrimin e tyre, ndërsa pas tyre mbeti një tjetër përvojë e përbashkët në ujërat shqiptare. Një përvojë që ndërthur miqësinë, profesionalizmin dhe bashkëpunimin ushtarak.

Nga Porti i Durrësit në det të hapur, Forcat Detare të Shqipërisë dhe Greqisë dëshmuuan edhe një herë se bashkëpunimi ndërtohet jo vetëm përmes marrëveshjeve, por edhe përmes takimeve, stërvitjeve, komunikimit dhe besimit të ndërsjellë.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Të plotësojmë nevojat kombëtare, të prodhojmë më shumë, më shpejt dhe së bashku. Ky ishte mesazhi që dha Samiti i Ankarasë për industrinë e mbrojtjes. Një nga temat dominuese të Samitit të NATO-s në Ankara (7–8 korrik 2026) ishte transformimi i industrisë së mbrojtjes. Në Forumin e Industrisë së Mbrojtjes u prezantuan programe shumëkombëshe për avionë zbulimi, dronë strategjikë, mbrojtje kundër dronëve, transport ajror strategjik, rritje të kapaciteteve prodhuese të industrisë së mbrojtjes etj. Në aspektin strategjik, samiti dërgoi tre sinjale kryesore: 1. Kalim nga rritja e shpenzimeve të rritja reale e prodhimit ushtarak kombëtar dhe vetë-furnizimit; 2. Ndërtim i një baze industriale më të integruar ndërmjet vendeve të NATO-s dhe 3. Përgatitje për një konkurrencë dhe përballje afatgjatë me kundërshtarë si Rusia, si dhe përballimin e kërcënimeve të reja të sigurisë.

NATO, kaloi nga logjika “të blejmë kur duhet” tek strategjia “të përgatitemi që të prodhojmë për një luftë të gjatë”. Ndërsa buxhetet e aleatëve për industrinë e mbrojtjes po rriten, problemi është prodhimi. Plani i NATO-s për prodhimin industrial ushtarak synon grumbullim kërkesë, standardizim, ndërveprueshmëri dhe rritje kapacitetesh. Kundërshtari i NATO-s, Rusia ka avantazh në ritëm mobilizimi resursesh, pasi prodhon më shpejt, pranon humbje më të larta dhe ka ekonominë më të centralizuar për luftë. NATO ka teknologji ushtarake superiore, por burokraci më të madhe, por dobësia kryesore e NATO-s është fragmentimi. Shumë shtete, shumë standarde, shumë procedura blerjeje. Kjo e ul shpejtësinë, duke kërkuar si zgjidhje heqjen e kufizimeve industriale brenda aleancës. Prioritetet janë të qarta, për të kaluar në prodhim të municioneve, mbrojtje ajrore, anti-dron, raketa, sisteme precize, logjistikë, inteligjencë artificiale, cyber dhe zinxhirë furnizimi.

Vetë-furnizimi e ul ekspozimin e vendit ndaj presionit politik, ekonomik ose ushtarak të furnitorëve të jashtëm. Prodhimi ose siguri brenda vendit i materialeve kritike, pjesëve të këmbimit, pajisjeve mbështetëse dhe shërbimeve të mirëmbajtjes zvogëlon kohën ndërmjet kërkesës dhe furnizimit. Kjo mundëson riparim më të shpejtë, plotësim më të mirë të rezervave dhe mbështetje më të qëndrueshme për Forcat e Armatosura. Në terma kombëtarë për Shqipërinë vetë-furnizimi nuk është vetëm çështje ekonomike. Shqipëria duke prodhuar vetë shumë elementë të kërkuar në industri të mbrojtjes, fiton më shumë liri vendimmarrjeje dhe nuk mbetet plotësisht e varur nga një shtet, kompani apo korridor i vetëm furnizimi. **Ai është siguri kombëtare, liri vendimmarrjeje dhe aftësi për të mbështetur vendin në paqe, krizë dhe konflikt. AIM është sot institucioni që e shndërron vizionin e NATO-s në Samit dhe kërkesën kombëtare për mbrojtje, në kapacitet industrial, inovacion teknologjik, siguri furnizimi dhe fuqi ekonomike.** Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes – AIM, është institucioni me vizionin, leadershipin dhe ekspertizën e duhur, që bën rregullimin, licencimin, mbikëqyrjen dhe nxitjen e industrisë së mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë. Zbërthimi në terma kombëtarë e detyrave të samitit është plan detyrash i AIM deri në samitin e Tiranës, me synimin final forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit, vetë-furnizimit dhe prodhim për aleatët.

Fokusi i samitit ishte kapaciteti industrial, ku NATO kërkon industri ushtarake të fortë, prodhim më të madh, zinxhirë furnizimi më të sigurt dhe aftësi për të dorëzuar kapacitete “me shpejtësi dhe në shkallë të gjerë”. Samiti kërkoi ritëm më të lartë prodhimi por qeveritë dhe industria duhet të bëjnë “më shumë, më shpejt dhe së bashku”. Kjo është përgjigje ndaj faktit që Rusia ka kaluar në ekonomi lufte dhe prodhim të vazhdueshëm, vetëm për luftën. NATO dha mbi 50 miliardë USD prokurime të reja për armët të afta për goditje në thellësi, mbrojtje ajrore/ raketore, sisteme pa pilot, teknologji të reja dhe inteligjencë, duke u përgatitur për garë kapacitetesh me Rusinë. Aleatët në samit krijuan koalicionë shumëkombëshe për prokurim dhe prodhim, sidomos në mbrojtje ajrore dhe kapacitete goditëse. Qëllimi është të mbyllën boshllëqet më shpejt dhe të shmangët varësia nga një vend i vetëm për elementë kritikë. NATO vlerëson se Rusia mund të vazhdojë presionin edhe pas 2026, sepse ka mobilizuar industrinë, municionet, dronët, raketat, ekonominë dhe logjistikën drejt luftës së gjatë. Prandaj përgjigjia e NATO-s është për prodhim më të madh, kontrata shumëvjeçare, rezerva, bashkëprodhim dhe kapacitete të shpejta industriale.

Kërcënimi rus në samitin e korrikut 2026 u vlerësua si fushatë presioni 360°, jo vetëm si sulm tokësor. Fronti nuk është vetëm në kufi fizik, por është edhe në rrjetet kompjuterike, media, porte, energji, industri mbrojtjeje, administratë, logjistikë dhe opinion publik.

Në samit u shpreh shqetësim për bashkëpunimin në rritje midis Kinës dhe Rusisë, sidomos në teknologjitë me përdorim të dyfishtë (civil dhe ushtarak), elektronikë, mikroçipa, materiale dhe komponentë industrialë që mund të mbështesin aftësitë ushtarake ruse. Samiti nënvizoi nevojën që industria e mbrojtjes e NATO-s të zvogëlojë varësinë nga zinxhirët globalë të furnizimit për materiale dhe teknologji kritike, duke rritur prodhimin brenda vendeve aleate.

Mbajtja e samitit në Shqipëri është objektiv i planifikuar dhe përfitim diplomatik mund të shfrytëzohet në fushata ndikimi. Në

AGJENCIA
E INDUSTRISE
SE MBROJTJES

PËRFITIMET E
VETËFURNIZIMIT

Vetëfurnizimi në industrinë e mbrojtjes forcon sovranitetin tonë, garanton sigurinë kombëtare dhe nxit zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

PAVARËSI
STRATEGJIKE
NË KOHË KRIZE

Siguron aftësinë për t'u përgjigjur në mënyrë të pavarur dhe të menjëhershme në çdo situatë krize.

ULJE E VARËSISË
NGA FURNIZUESIT
E HUAJ

Redukton varësinë nga të tjerët dhe rrit sigurinë e furnizimit me armatim dhe municion.

KRIJIM VLERE
EKONOMIKE
KOMBËTARE

Shton vlerën e prodhimit vendas dhe kontribuon në rritjen ekonomike të vendit.

GJENERIM
VENDESH PUNE
DHE ZHVILLIM
TEKNOLOGJIK

Krijon vende pune të qëndrueshme dhe nxit inovacionin e transferimin e teknologjisë.

SIGURI MË E MADHE
PËR ZINXHIRIN
USHTARAK

Forcon qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit ushtarak në çdo kohë.

INDUSTRI E FORTË

ATDHE I SIGURT

E ARDHMË E QËNDRUESHME

AGJENCIA E INDUSTRISE SË MBROJTJES - AIM

Sfidat e industrisë ushtarake: vetë-furnizim, prodhim në sasi, shpejt dhe së bashku

vlerësimin e inteligjencës, Industria shqiptare e Mbrojtjes dhe Samiti i radhës i NATO-s në Tiranë, 2027, do të ishin objektiva tërheqës për operacione hibride ruse, jo domosdoshmërisht për sulm frontal. Rusia do të kishte interes të godiste imazhin e Shqipërisë si vend pritës i sigurt, më shumë sesa të godiste drejtpërdrejt kapacitetet ushtarake. Objektivi nuk do të ishte vetëm dëmi fizik, por krijimi i narratives: “Shqipëria nuk është e aftë të garantojë sigurinë e një samiti të NATO-s”. Kjo do t'i shërbente qëllimit kryesor që është diskreditimi i Shqipërisë brenda NATO-s. Do të “sajohen” dyshime për shpenzimet e mbrojtjes apo kapacitetet industriale, si dhe do të ushtrohet presion psikologjik ndaj publikut dhe institucioneve me frikë, konfuzion, panik mediatik, polarizim politik. Ky është skenar që e kemi “lexuar” në luftën hibride ruse të paktën nga 2022.

“Kërcënimi rus nuk është vetëm frontal” - vlerësoi samiti. Kjo do të thotë se Rusia nuk synon vetëm përballje ushtarake në kufi, por do të përdorë presion të shumëfishtë sidomos kundër industrisë së mbrojtjes së aleancës. Rreziku nuk është vetëm në vijën e frontit. Objektiva mund të jenë kablo nënujore, rrjete energjie, porte, hekurudha, aeroporte, industria e mbrojtjes depozitike dhe sisteme komunikimi. BE-ja ka dënuar aktivitetë hibride ruse që përfshijnë sabotim, ndërprerje infrastrukture, cyber dhe ndërhyrje informative. Rusia mund të godasë pa dërguar trupa, me sulme ndaj sistemeve shtetërore, industrisë së mbrojtjes, mediave, zgjedhjeve dhe opinionit publik. Qëllimi është dobësimi i besimit të institucionet dhe krijimi i konfuzionit.

Industria e mbrojtjes vlerësohet se është objektiv sepse aty ka teknologji, plane prodhimi, kontrata, furnizime dhe personel me akses. Kërcënimi mund të vijë nga brenda industrisë, nga punonjës të komprometuar, kontraktorë, kompani ndërmjetëse

ose rrjete ndikimi.

Presioni mbi energjinë, çmimet, zinxhirët e furnizimit dhe materialet kritike, mund të përdoret për të lodhur vendet e NATO-s politikisht dhe ekonomikisht, pa hapur luftë të drejtpërdrejtë. Më i rrezikshëm është sabotimi që duket si “defekt”, “gabim administrativ”, “incident teknik” ose “aksident logjistik” në subjektet e licencuara të prodhimeve ushtarake në Shqipëri. Ky lloj kërcënimi do të synojë të krijojë vonesë, humbje besimi, hetime publike, krizë mediatike. Goditje ndaj zinxhirit të furnizimit mund të kryhet jo domosdoshmërisht ndaj fabrikave kryesore. Më lehtë goditen furnitorët e vegjël në transport, mirëmbajtje, IT, magazina, kompani private sigurie, furnizime energjie. Rreziku kryesor nuk është një sulm i pritshëm klasik ushtarak. Rreziku kryesor është operacion hibrid me efekt politik me cyber + dezinformim + incident teknik + panik publik + presion diplomatik.

Operacionet aktuale hibride të përforcuara me IA duhen trajtuar si operacione kombëtare sigurie, ku industria e mbrojtjes është një nga frontet më të ndjeshme. Dezinformim dhe operacione ndikimi mund dhe do të ndërmerren duke krijuar narrativa të mundshme dhe të “besueshme” për industrinë e mbrojtjes. Për Shqipërinë, samiti Tirana 2027 nënkupton mundësi më të mëdha për industrinë tonë të mbrojtjes, përfshirje në zinxhirët e furnizimit të NATO-s, rritje të investimeve dhe bashkëpunim më të ngushtë me industrinë e aleancës. Për inteligjencën dhe sigurinë kjo do të thotë vigjencë të shtuar për siguri industriale, cyber, kontroll personeli, mbrojtje infrastrukture, kundërzbulim dhe komunikim strategjik. Këto masa janë po aq të rëndësishme sa pajisjet ushtarake, vetë-furnizimi dhe armët e zjarrit.

Sfidat dhe Triumfet e Gruas në Uniformë

Sot, imazhi i Forcave të Armatosura nuk mund të imagjinohet pa kontributin e paçmuar të personelit femëror. Nga zyrat e logjistikës e deri në kabinat e helikopterëve apo në misione paqeruajtëse, gratë dhe vajzat në uniformë kanë dëshmuar se profesionalizmi, guximi dhe devotshmëria nuk njohin gjini.

Të ndërtosh një karrierë të tillë si femër në një mjedis tradicionalisht të dominuar nga burrat, mbart sfida të dyfishta. Për Aidën, uniforma nuk ka qenë kurrë një pengesë, por një motivim për të treguar se suksesi ushtarak matet me paanshmëri, profesionalizëm dhe karakter. Ajo ka thyer barrierat dhe paragjykimet, duke u bërë një model udhëheqëse jo vetëm për vajzat dhe gratë që aspirojnë të hyjnë në FA, por për mbarë trupën ushtarake.

Të mbash gradën dhe pozicionin e Kryenënoficerit të Forcës Ajrore është një përgjegjësi monumentale. Të jesh e vetmja femër në këtë pozicion do të thotë të jesh njëkohësisht pioniere dhe urë lidhëse. Shpeshherë, grave në ushtri u duhet të punojnë dy herë më shumë për të provuar veten dhe për të fituar të njëjtin respekt si kolegët e tyre meshkuj. Si e vetmja femër, ky rol mbart një peshë specifike. Ajo përfaqëson nevojat dhe aspiratat e të gjithë personelit, duke thyer mitin se postet e larta komanduese të nënoficerëve u takojnë vetëm burrave, duke dëshmuar se autoriteti nuk buron nga forca fizike, por nga integriteti dhe profesionalizmi.

Të shërbesh në elitën e Forcave të Armatosura kërkon një shkallë të lartë disipline, përkushtimi dhe aftësish udhëheqëse. Kur bëhet fjalë për Kryekapter Aida Guxhën, e cila mban detyrën e rëndësishme si Kryenënoficer i Forcës Ajrore (Command Senior Enlisted Leader) në Komandën e Forcës Ajrore Rinas, kjo sfidë merr përmasa edhe më fisnike. Përtej profilit të lartë zyrtar dhe përgjegjësisë së gradës OR-9, jeta e saj është një mozaik i jashtëzakonshëm ku ndërthuren misionet e rrezikshme jashtë vendit, takimet e nivelit të lartë në NATO, sfidat e të qenit femër në uniformë, rritja e fëmijëve, statusi i ri si gjyshe, dhe pasioni i hershëm për këngën dhe flautin.

**Nga Fronti i Afganistanit në Takimet e NATO-s**

Karriera e Kryekapter Aida Guxhës nuk është ndërtuar vetëm zyra të komandës. Ajo mban mbi supe përvojën e vyer dhe sfidat e jashtëzakonshme të misioneve paqeruajtëse ndërkombëtare, ku veçohet shërbimi i saj në Afganistan. Në një terren aq të vështirë dhe me rreziqe të larta, ajo tregoi profesionalizëm, kurajë dhe devotshmëri, duke lënë gjurmë si një përfaqësuese dinjitoze e ushtrisë shqiptare.



Melodia e Forcës Ajrore: Si i menaxhon Kryekapter Aida Guxha, Flautin, Këngën dhe Lidërshtipin Ushtarak

Nga Sfidat në Afganistan te Skenat Ndërkombëtare Profili i Kryenënoficerit që Harmonizon Jetën në Uniformë me Atë Familjare dhe Artin



Sot, përfaqësimi i saj shtrihet edhe në nivelet më të larta të lidërshtipit të nënoficerëve, duke marrë pjesë aktive në takimet dhe konferencat e NATO-s. Si Command Senior Enlisted Leader, Aida ngre zërin dhe ndan përvojën e Forcës Ajrore shqiptare me aleatët strategjikë, duke dëshmuar rritjen dhe modernizimin e trupës së nënoficerëve.

Flauti dhe Kënga: Shpirti Artistik që Ndjek Karrierën

Nëse gjatë ditës angazhimi i saj lidhet me menaxhimin, takimet ndërkombëtare apo mbarëvajtjen e trupës së nënoficerëve, orët e lira i takojnë artit. Gërshtetimi i zërit të saj në aktivitetet e Korit Ndërkombëtar “Bujart” dhe pasioni

për të luajtur në flaut krijojnë një profil unik njerëzor.

Flauti, si një instrument që kërkon frymëmarrje të kontrolluar dhe saktësi absolute, ngjan shumë me disiplinën ushtarake. Ndërsa kënga në korin ndërkombëtar funksionon si një urë diplomatike kulturore, ku përcillen mesazhe paqeje dhe bashkëpunimi mbarë vëndit tonë dhe në skenat botërore.

Përbushja Më e Madhe: Nëna dhe Gjyshja e Lumtur

Përtej misionëve në Afganistan, takimeve në NATO dhe skenave të artit, për Aidën ekziston një tjetër mision jetësor po aq i rëndësishëm: familja. Ajo ka arritur të jetë një nënë e përkushtuar, duke rritur e edukuar fëmijët e saj me vlerat e punës dhe të ndershmërisë, shpesh duke sakrifikuar kohën e saj për shkak të dërgimeve apo shërbimeve ushtarake.

Së fundmi, jetës së saj i është shtuar një tjetër titull i shenjtë dhe plot dritë – të qenit gjyshe. Ky status i ri sjell një përbushje të jashtëzakonshme emocionale. Kur kthehet në shtëpi pas një dite të ngjeshur me detyra ushtarake apo prova korale, është pikërisht nipi që ia mbush shpirtin me gëzim dhe i kujtojnë vlerën e vërtetë të paqes për të cilën ajo shërben në uniformë.

Një Shembull Frymëzimi në FA

Kryekapter Aida Guxha dëshmon se ushtarakët tanë janë individë të plotësuar, të cilët mund të menaxhojnë me sukses lidërshtipin ushtarak, përfaqësimin në NATO, artin dhe ngrohtësinë e vatrës familjare. Ajo mbetet një shembull i shkëlqyer frymëzimi për çdo efektiv të Forcave të Armatosura, duke treguar se me vullnet, disiplinë dhe shumë dashuri, mund të jesh njëkohësisht një ushtarakë elitare, një artiste e talentuar dhe një gjyshe plot dashuri.

Nga redaksia e gazetës



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga armët që dikur mbrojtën kufijtë e vendit, te dokumentet që dëshmojnë sakrificat e brezave, nga uniformat e ushtarakëve shqiptarë ndër dekada, te teknologjia moderne që rrëfen historinë në një mënyrë bashkëkohore, Muzeu i Forcave të Armatosura është sot shumë më tepër se një hapësirë ekspozimi.

Ai është një destinacion ku historia merr jetë dhe ku çdo vizitor ka mundësinë të udhëtojë në kohë, duke njohur evolucionin e ushtrisë shqiptare dhe rolin e saj në mbrojtjen e shtetit.

Në një kohë kur turizmi kulturor po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe, muzetë nuk konsiderohen më vetëm vende ku ruhen objekte të së kaluarës. Ata janë kthyer në qendra edukimi, identiteti dhe komunikimi me publikun. Pikërisht në këtë filozofi ndërtohet edhe roli i Muzeut të Forcave të Armatosura, një institucion që ruan kujtesën historike të ushtrisë shqiptare dhe e sjell atë pranë brezave të rinj me një gjuhë të kuptueshme dhe tërheqëse.

Një rrugëtim në historinë e ushtrisë shqiptare

Çdo objekt i ekspozuar në muze bart një histori. Një uniformë nuk është vetëm një veshje ushtarake, ajo është dëshmi e kohës kur është përdorur, e misionëve të kryera dhe e njerëzve që e kanë veshur me përgjegjësi e përkushtim. Një armë nuk paraqet vetëm zhvillimin teknik të një epoke, por edhe sfidat e mbrojtjes së vendit në periudha të ndryshme historike.

Një hartë operative, një fotografi bardhezi, një urdhër ushtarak apo një medalje nderi janë pjesë të mozaikut të memories kombëtare.

Vizitori nuk sheh vetëm objekte. Ai lexon historinë e një institucioni që ka ecur paralelisht me vetë historinë e shtetit shqiptar.

Nga periudha e krijimit të ushtrisë kombëtare, te zhvillimet e shekullit XX, transformimi pas viteve '90 dhe integrimi në NATO, muzeu ndërton një rrëfim kronologjik që ndihmon për të kuptuar se si kanë evoluar Forcat e Armatosura dhe misioni i tyre.

Një muze që flet edhe për paqen

Paradoksi më i bukur i një muzeu ushtarak është se ai nuk promovon luftën.

Përkundrazi, ai tregon se sa e shtrenjtë është paqja. Pas çdo uniforme, pas çdo fotografie dhe pas çdo objekti ekspozimi fshihen histori njerëzish që kanë shërbyer me ndjenjën e detyrës, shpesh në kushte të vështira dhe me sakrifica personale.

Pikërisht kjo e bën muzeun një hapësirë reflektimi. Ai kujton se siguria dhe paqja nuk janë të mirëqena, por ndërtohen përditë nga institucione të forta, profesionalizëm dhe përkushtim.

Një destinacion për të rinjtë

Në shumë vende të NATO-s, muzetë ushtarakë janë ndër destinacionet më të vizituara nga nxënësit dhe studentët.

Ata nuk shkojnë vetëm për të parë armë apo automjete ushtarake. Ata shkojnë për të kuptuar historinë, teknologjinë, zhvillimin e shkencës ushtarake dhe evolucionin e shtetit.

Edhe Muzeu i Forcave të Armatosura ka potencial të luajë këtë rol.

Vizitat e organizuara të shkollave, studentëve, kadetëve dhe të rinjve krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me historinë

Muzeu i Forcave të Armatosura, aty ku historia takohet me kujtesën dhe turizmin kulturor



kombëtare. Në një epokë të dominuar nga informacioni dixhital, kontakti me objektet autentike mbetet një përvojë që nuk mund të zëvendësohet nga asnjë ekran.

Turizmi ushtarak, një mundësi në rritje

Në Europë, turizmi ushtarak është kthyer në një segment të rëndësishëm të turizmit kulturor.

Muzetë e ushtrive, fortifikimet historike, bazat detare, aeroportet ushtarake të hapura për publikun dhe ekspozitat e pajisjeve ushtarake tërheqin çdo vit miliona vizitorë.

Ky interes nuk lidhet vetëm me historinë e luftërave. Ai lidhet me kuriozitetin për teknologjinë, zhvillimin e industrisë së mbrojtjes dhe historinë e institucioneve shtetërore.

Shqipëria ka potencial të zhvillojë edhe këtë dimension të turizmit.

Muzeu i Forcave të Armatosura po shndërrohet në një pikë referimi për vizitorët shqiptarë dhe të huaj, veçanërisht për ata që kërkojnë të njohin historinë moderne të vendit përmes institucioneve të tij.

Historia që nuk duhet të harrohet

Një komb nuk ndërton të ardhmen duke harruar të kaluarën. Ruajtja e kujtesës historike është pjesë e identitetit kombëtar. Në këtë kuptim, muzeu kryen një mision që shkon përtej ekspozimit të objekteve.

Ai dokumenton rrugëtimin e Forcave të Armatosura, nderon kontributin e brezave të ushtarakëve dhe u jep brezave të rinj mundësinë të kuptojnë se çfarë do të thotë shërbim ndaj atdheut.

Çdo vizitor largohet me diçka më shumë sesa informacion. Ai largohet me një ndjenjë respekti për historinë, për institucionin ushtarak dhe për njerëzit që kanë kontribuar në mbrojtjen e Shqipërisë.

Një urë mes së kaluarës dhe së ardhmes

Në një kohë kur Forcat e Armatosura po modernizohen, po pajisen me teknologji të reja dhe po marrin pjesë në misione ndërkombëtare, Muzeu i Forcave të Armatosura mbetet pika ku rrënjët historike lidhen me vizionin për të ardhmen. Ai dëshmon se modernizimi nuk do të thotë të harrosh të kaluarën, por ta njohësh atë për të ndërtuar më mirë të nesërmen. Në këtë kuptim, muzeu nuk është vetëm një institucion kulture. Ai është një laborator i kujtesës kombëtare, një qendër edukimi qytetar dhe një ambasador i historisë ushtarake shqiptare.

Për këdo që dëshiron të kuptojë më mirë rrugëtimin e Shqipërisë, sakrificat e ushtarakëve të saj dhe transformimin e Forcave të Armatosura në një ushtri moderne të NATO-s, një vizitë në Muzeun e Forcave të Armatosura është një udhëtim që vlen të përjetohet. Sepse aty historia nuk qëndron e mbyllur në vitrina; ajo vazhdon të flasë me gjuhën e kujtesës, të identitetit dhe të vlerave që ndërtojnë një komb.

- Pesë arsye pse duhet të vizitoni Muzeun e Forcave të Armatosura**
- Njihni historinë e ushtrisë shqiptare**
Nga krijimi i shtetit shqiptar deri te integrimi në NATO.
 - Shihni objekte autentike**
Uniforma historike, armë, dokumente, medalje, fotografi dhe pajisje që kanë shoqëruar Forcat e Armatosura ndër dekada.
 - Kuptoni transformimin e ushtrisë**
Një rrugëtim nga modelet tradicionale drejt një force moderne, profesionale dhe të integruar në Aleancën Atlantike.
 - Përjetoni historinë nga afër**
Çdo objekt mbart historinë e njerëzve që i shërbyen vendit me përkushtim.
 - Zbuloni një destinacion kulturor unik**
Një muze që ndërthur historinë, edukimin, identitetin kombëtar dhe turizmin kulturor.



NOSTALGJIA E NJË KOHE QË NUK KTHEHET

ANJEZA MUSOLLARI, Shefe e Sektorit të Botimeve

“Ka kohë që nuk na mungojnë sepse ishin më të mira. Na mungojnë sepse na kujtojnë njerëzit që ishim”

Historia nuk ecën mbrapsht, ajo nuk njeh kthime, nuk njeh përsëritje. Çdo brez lind në kohën e vet, ndërton ëndrrat e veta dhe përballet me sfidat që i rezervon epoka ku jeton. Megjithatë, ekziston një paradoks që shfaqet në çdo shoqëri: sa më shumë ecim drejt së ardhmes, aq më shpesh e kthejmë kokën pas. Shqipëria nuk bën përjashtim, madje, ndoshta është një nga vendet ku e shkuara vazhdon të jetë më e pranishme se kudo tjetër. Ajo shfaqet në bisedat e përditshme, në fotografitë e vjetra të familjeve, në këngët që vazhdojnë të këndohen, në filmat që transmetohen ende me të njëjtin emocion, në rrëfimet e gjyshërve, por edhe në kureshtjen e brezave që nuk e kanë jetuar atë kohë.

Sa herë dëgjon një bisedë mes njerëzve të moshave të ndryshme, kupton se vitet gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë vazhdojnë të jetojnë në kujtesën kolektive të shqiptarëve.

Dikush kujton shkollën. Një tjetër lagjen. Një tjetër fabrikën ku punoi për tridhjetë vjet. Dikush kujton ushtrinë. Një tjetër festivalet e këngës.

Një tjetër mbrëmjet verore kur njerëzit nxirrnin karriget përpara shtëpive dhe bisedonin deri vonë. Madje edhe shumë të rinj, që kanë lindur dekada më vonë, dëgjojnë me kureshtje rrëfimet e prindërve dhe gjyshërve. Kërkojnë fotografi bardhezi, shohin filmat e Kinostudios, dëgjojnë këngët e atyre viteve dhe përpiqen të kuptojnë një Shqipëri që nuk e kanë njohur kurrë.

Kjo më ka bërë të ndalem shpesh në një pyetje.

Pse ndodh kjo?

Pse një brez që nuk e ka jetuar atë kohë ndien nevojën ta njohë? Pse një brez që jeton në epokën e internetit, inteligjencës artificiale dhe globalizimit vazhdon të ndalet te fotografitë e zverdhura të një Shqipërie pa telefona celularë, pa autostrada, pa qendra tregtare dhe pa kufij të hapur?

Ndoshta përgjigjia nuk është aq e thjeshtë sa duket.

Sepse nostalgia nuk është gjithmonë mall për një epokë. Shpesh është mall për njeriun.

Nostalgjia nuk është ideologji

Në Shqipëri, sa herë përmenden vitet para 1990-ës, debati rrëshqet pothuajse menjëherë në politikë. Njëra palë sheh vetëm errësirën. Tjetra sheh vetëm dritën. Njëra flet vetëm për mungesën e lirisë. Tjetra vetëm për sigurinë sociale.

Dhe, mes këtyre dy skajeve, humbet njeriu.

Humbet jeta e përditshme. Humbet mënyra se si jetonin familjet shqiptare. Humbet mënyra si ndërtoheshin marrëdhëniet. Humbet kultura e komunitetit. Sepse historia nuk është vetëm historia e sistemeve politike. Historia është, mbi të gjitha, historia e njerëzve. Është historia e nënës që zgjohej herët për të përgatitur fëmijët për në shkollë. Është historia e mësuesit që hynte në klasë me respektin që sot rrallë e gjen. Është historia e ushtarit që shërbente me bindjen se po kryente një detyrë ndaj atdheut. Është historia e inxhinierit, e mjekut, e artistit, e punëtorit, e fermerit, e sportistit. Ata nuk ishin ideologji.

Ishin njerëz. Dhe pikërisht këtu fillon nostalgia. Jo te politika. Por te kujtimet.

Dy Shqipëri, një popull

Brezi im nuk e ka jetuar atë Shqipëri. Ne u rritëm në një vend krejt tjetër. Në një Shqipëri ku kufijtë ishin të hapur. Ku mund të udhëtoje. Ku mund të studioje jashtë. Ku interneti e solli botën brenda telefonit. Ku zgjedhja u bë një e drejtë dhe jo një privilegj. Ne kemi pasur mundësi që prindërit tanë nuk i kishin. Por kemi edhe pasiguri që ata nuk i njihnin. Ata jetonin me më pak zgjedhje. Ne jetojmë me pafundësi zgjedhjesh. Ata njihnin pothuajse të gjithë fqinjët. Ne shpesh nuk njohim as ata që jetojnë në apartamentin përballë. Ata kishin më pak mjete komunikimi. Ne kemi komunikim të pandërprerë. Paradoksalisht, ata bisedonin më shumë. Ne shkruajmë më shumë. Ata prisnin gjithë javën për të parë një film. Ne kemi mijëra filma në dispozicion. Por rrallë i shohim bashkë. Ata kishin një televizor. Ne kemi nga një ekran për çdo anëtar të familjes. Por sa familje darkojnë ende duke biseduar?

Nuk kemi humbur vetëm kohën

Nëse do të pyesnim sot një gjysh se çfarë i mungon më shumë nga rinia e tij, rrallëherë do të fliste për politikën. Ai do të fliste për njerëzit. Për lagjen. Për shokët. Për lojërat. Për prindërit. Për festat. Për një kohë kur dera nuk mbyllej me çelës. Kur fqinji hynte në shtëpi pa trokitur. Kur një filxhan kafe zgjaste dy orë. Kur fëmijët nuk kishin nevojë për një telefon që të gjenin shokët. Mjaftonte të dilnin në rrugë.

Nuk ishte një botë perfekte. Aspak.

Ishte një botë me mungesa. Me kufizime. Me padrejtësi. Por ishte edhe një botë ku njeriu kishte më shumë kohë për njeriun. Dhe ndoshta kjo është ajo që mungon më shumë sot. Jo e shkuara. Por afërsia. Jo sistemi. Por marrëdhëniet. Jo varfëria. Por solidariteti.

NOSTALGJIA E NJË KOHE QË NUK KTHEHET

Familja, shkolla dhe komuniteti, pasuria që nuk matej me para

Nëse do të kishte një fjalë që përshkruan më mirë Shqipërinë e viteve ‘60, ‘70 dhe ‘80, ajo ndoshta nuk do të ishte as “sakrificë”, as “izolim”, as “disiplinë”. Do të ishte një fjalë shumë më e thjeshtë:

Bashkë.



Shqiptarët jetonin më afër njëri-tjetrit. Jo vetëm fizikisht. Shpirtërisht. Në një kohë kur shtëpitë ishin më të vogla, oborret më të ngushta dhe komoditeti pothuajse i panjohur, paradoksalisht ekzistonte një pasuri që sot duket gjithnjë e më e rrallë: koha për njeriun. Nuk kishte telefona inteligjentë. Nuk kishte internet. Nuk kishte rrjete sociale. Megjithatë, njerëzit komunikonin më shumë. Vizitat nuk planifikoheshin me mesazhe. Trokitja në derë nuk ishte bezdi. Ishte kënaqësi. Kafeja nuk pihej me nxitim. Ajo ishte një ritual. Një arsye për të dëgjuar, për të rrëfyer, për të ndarë hallet dhe gëzimet.

Në shumë lagje shqiptare, një fëmijë nuk rritej vetëm nga prindërit. Ai rritej nga e gjithë lagjia. Nëse rrëzohej, dikush e ngrinte. Nëse gabonte, dikush e këshillonte. Nëse mungonte në shtëpi, gjithmonë kishte dikush që dinte ku ishte. Sot kjo mund të tingëllojë romantike. Por për mijëra shqiptarë ishte përditshmëri.

Familja, institucioni që nuk kishte nevojë për teori

Në Shqipërinë e atyre viteve, familja nuk ishte vetëm një lidhje gjaku.

Ishte një institucion. Një universitet i heshtur. Një vend ku mësohej respekti, përgjegjësia, sakrifica dhe durimi. Tre breza jetonin shpesh nën të njëjtën çati. Gjyshërit nuk ishin vizitorë të fundjavës. Ishin pjesë e edukimit të përditshëm. Ata nuk kishin diploma në psikologji. Por kishin urtësinë që vinte nga jeta. Fëmijët mësonin të dëgjonin. Jo sepse kishin frikë. Por sepse respektonin.

Sot jetojmë më rahat. Shtëpitë janë më të mëdha. Komoditeti është më i madh. Por shumë familje jetojnë më larg njëra-tjetrës se kurrë. Shpesh një video-telefonatë zëvendëson një përqafim. Një mesazh zëvendëson një vizitë. Një emoji zëvendëson një buzëqeshje. Teknologjia na ka afruar me botën. Por ndonjëherë na ka larguar nga tavolina e shtëpisë. Ka një paradoks që ia vlen të mendohet. Sot kemi më shumë mundësi të komunikojmë. Por kemi më pak kohë për të biseduar.

Shkolla, vendi ku formohej karakteri

Nostalgjia për arsimin e atyre viteve nuk lidhet vetëm me tekstet apo me uniformën. Lidhet me respektin. Mësuesi ishte një figurë autoriteti. Kur hynte në klasë, ngrihej e gjithë klasa. Jo nga frika. Nga edukata. Prindërit nuk e shihnin mësuesin si kundërshtar. E shihnin si aleatin më të rëndësishëm në formimin e fëmijës. Libri nuk ishte një detyrim. Ishte një pasuri. Bibliotekat e shkollave ishin vende të mbushura. Leximi ishte pjesë e jetës. Sot shkolla ka laboratorë modernë. Ka internet. Ka mundësi që dikur dukeshin të pamundura. Por përballë teknologjisë është shfaqur një sfidë e re. Informacioni është bërë i pafund. Ndërsa përqendrimi është bërë gjithnjë e më i rrallë. Nxënësi i sotëm di më shumë. Por shpesh lexon më pak. Ka më shumë burime.

Por më pak durim për t'i shfrytëzuar. Nuk është faj i brezit të ri.

Është ritmi i kohës. Prandaj sfida nuk është të kthehemi pas. Është të ruajmë respektin për dijen në një epokë ku gjithçka duket e menjëhershme.

Puna, krenari dhe sfidë

Një nga kujtimet që përsëritet më shpesh nga brezi i viteve ‘60, ‘70 dhe ‘80 është puna. Jo sepse puna ishte e lehtë. Përkundrazi. Ishte e lodhshme. Por kishte një dimension moral. Profesionit ishte pjesë e identitetit. Kur dikush prezantohej, thuhej: “Është mjek”, “Është ushtarak”, “Është inxhinier”, “Është mësuese”, “Është mekanik”. Puna nuk ishte vetëm mënyrë për të jetuar. Ishte mënyrë për të qenë i dobishëm.

Sot kemi më shumë liri profesionale.

Mund të ndryshojmë punë. Mund të krijojmë biznes. Mund të punojmë për kompani në anën tjetër të botës. Por kemi edhe një pasiguri që brezat e mëparshëm nuk e njihnin.

Shumë të rinj nuk pyesin më: “Çfarë profesioni dua?”. Pyesin: “Në cilin shtet do ta ushtroj?”

Ky është ndryshimi më i madh i epokës sonë. Liria ka sjellë mundësi. Por ka sjellë edhe largime. Emigracioni nuk është vetëm statistikë. Është boshatisje e lagjeve. Është mungesë në sofrat familjare. Është një gyshe që pret nipin vetëm gjatë pushimeve.

Komuniteti, fjala që po bëhet e rrallë

Në të kaluarën, komuniteti nuk ishte një koncept sociologjik. Ishte mënyrë jetese. Në dasma merrte pjesë e gjithë lagjia. Në fatkeqësi askush nuk mbetej vetëm. Kur ndërtohej një shtëpi, ndihmonin të gjithë. Kur dikush kishte nevojë, nuk pyetej nëse ishte i afërm. Pyetej vetëm: “Çfarë mund të bëjmë?”.

Sot jetojmë në një shoqëri më individualiste.

Kjo nuk është domosdoshmërisht negative. Individualizmi ka sjellë iniciativë.

Ka nxitur sipërmarrjen. Ka rritur lirinë personale. Por ka dobësuar një pjesë të lidhjeve shoqërore. Dhe pikërisht këtu lind nostalgia. Jo për mungesën e lirisë. Por për praninë e njëri-tjetrit. Për ndjenjën se askush nuk ishte vetëm. Ndoshta kjo është arsyeja pse, edhe sot, shumë shqiptarë nuk kujtojnë me mall ndërtesat apo rrugët e asaj kohe. Ata kujtojnë njerëzit. Sepse ndërtesat shemben. Rrugët ndryshojnë. Por mënyra si të ka bërë të ndihesh një komunitet mbetet gjatë në kujtesë. Dhe ndoshta kujtesa nuk është arkivi i ngjarjeve. Është arkivi i emocioneve.

Kur uniforma ishte edukim, libri - autoritet dhe kënga bashkonte një komb. Ka një gabim që e bëjmë shpesh kur flasim për të kaluarën. E shohim vetëm përmes syve të politikës.

Dhe harrojmë se çdo epokë ndërtohet, para së gjithash, nga njerëzit e zakonshëm. Historia nuk është vetëm ajo që shkruhet në dokumente. Historia është ajo që jeton në kujtesën e një mësueseje që për tridhjetë vjet hyri në klasë me të njëjtin përkushtim. Është ajo që kujton një infermiere që kaloi net pa gjumë në spital. Është ajo që mban mend një ushtarak që shërbeu larg familjes. Është ajo që ndien një artist kur dëgjon ende duartrokitjet e publikut. Janë këto histori që ndërtojnë shpirtin e një kombi.

Uniforma si shkollë karakteri

Në dekadat e viteve ‘60, ‘70 dhe ‘80, ushtria ishte shumë më tepër sesa një institucion mbrojtjeje. Për mijëra të rinj, ajo ishte një shkollë jete. Në radhët e saj mësohej disiplina, përgjegjësia, respekti për kohën, puna në grup dhe ndjenja se interesi i përbashkët ishte më i rëndësishëm se ai individual. Sigurisht, ajo kohë kishte edhe ngarkesën e sistemit politik ku zhvillohej. Por, përtej ideologjisë, mbetën disa vlera që nuk kanë datë skadence. Disiplina. Përpikëria. Besnikëria ndaj detyrës. Përgjegjësia për shokun. Respekti për flamurin. Këto nuk janë vlera të një sistemi. Janë vlera universale. Edhe sot, kur Forcat e Armatosura Shqiptare janë pjesë e NATO-s dhe ushtarakët tanë shërbejnë në misione ndërkombëtare, thelbi i profesionit mbetet i pandryshuar.

Ndryshojnë teknologjitë. Ndryshojnë armët. Ndryshojnë doktrinat. Por karakteri mbetet arma më e rëndësishme e një ushtaraku. Dhe karakteri nuk ndërtohet me pajisje moderne. Ai ndërtohet me edukim.

Kur arti ishte pjesë e jetës së përditshme

Nëse ka një fushë ku nostalgia shfaqet më fort se kudo tjetër, ajo është kultura. Mjafton të dëgjosh disa akorde të një kënge të vjetër dhe menjëherë fillojnë kujtimet. Nuk është rastësi. Këngët e atyre viteve nuk ishin thjesht argëtim. Ato ishin pjesë e jetës. Festivali i fundvitit nuk ishte vetëm një program televiziv. Ishte një ngjarje kombëtare. Familjet mblidheshin para ekranit të vetëm që kishin në shtëpi. Diskutonin. Prisin. Debatonin.

Këngët këndoheshin për muaj të tërë. Sot kemi qindra televizione. Mijëra platforma. Miliona këngë. Por sa prej tyre arrijnë të bashkojnë një komb të tërë?

Teknologjia na ka dhënë pafundësi zgjedhjesh.

Por ndonjëherë zgjedhjet e tepërta krijojnë vetmi kulturore. Secili dëgjon muzikën e vet. Sheh filmin e vet.



Jeton në algoritmin e vet. Dikur kultura krijonte kujtime të përbashkëta. Sot krijon përvoja individuale. Asnjëra nuk është domosdoshmërisht më e mirë. Janë thjesht dy botë të ndryshme.

Sporti si krenari kombëtare

Edhe sporti kishte një vend të veçantë në jetën shqiptare. Fitoret nuk ishin vetëm të sportistit. Ishin të të gjithëve. Një medalje festohej në çdo qytet. Një rekord bëhej krenari kombëtare. Njerëzit e ndiqnin sportin jo vetëm për rezultatin. Por sepse ndiheshin pjesë e tij. Sot sporti është profesionalizuar. Sportistët tanë garojnë në arenat më të mëdha të botës. Kjo është një arritje e jashtëzakonshme. Por ndonjëherë mungon ajo ndjenjë e përkatësisë kolektive që e kthente çdo fitore në një festë të të gjithë shqiptarëve.

Media, nga fjala që pritej te zhurma që nuk pushon

Ka edhe një ndryshim tjetër që ndoshta shpjegon nostalgjinë. Mënyra si informohemi. Dikur lajmi kishte ritëm. Njerëzit prisnin gazetën. Prisnin emisionin e mbrëmjes. Prisnin radion. Informacioni ishte më i kufizuar. Por kishte kohë të përtypjej. Sot jetojmë nën një stuhi informacioni. Çdo minutë prodhohen lajme të reja. Opinione të reja. Video të reja. Reagime të reja. Paradoksi është i madh. Dimë më shumë. Por kuptojmë më pak. Lexojmë më shumë tituj. Por më pak libra. Komunikojmë më shumë. Por dëgjojmë më pak.

Morali nuk ka epokë

Ndoshta pyetja më e rëndësishme nuk është nëse dje ishte më mirë apo sot është më mirë. Pyetja është tjetër: **Çfarë vlerash nuk duhet të humbasë kurrë një shoqëri?** Respekti. Ndershmëria. Fjala e dhënë. Dinjiteti i punës. Dashuria për familjen. Përgjegjësia ndaj komunitetit. Këto nuk janë vlera komuniste. As demokratike. Janë vlera njerëzore. Dhe pikërisht këto vlera janë arsyeja pse shumë njerëz flasin me mall për një kohë që nuk mund të rikthehet. Jo sepse duan të rikthejnë të kaluarën. Por sepse nuk duan të humbasin atë që kishte më të mirë.

Liria që fituam, vlerat që nuk duhet t'i humbasim

Çdo brez ka prijren ta gjykojë kohën e vet si më të vështirën. Është një refleks njerëzor. Ata që jetuan luftërat besonin se brezat pas tyre do të kishin një jetë më të lehtë. Ata që jetuan varfërinë menduan se mirëqenia do të sillte lumturinë. Ata që jetuan pa liri ëndërruan ditën kur do të mund të flisnin pa frikë.

Dhe ajo ditë erdhi. Pas viteve '90 Shqipëria hyri në një rrugë të re. Një rrugë që nuk ishte e lehtë. Ishte e mbushur me pasiguri, me gabime, me zhgënjime, por edhe me mundësi që brezat e mëparshëm nuk i kishin njohur kurrë. Për herë të parë, shqiptarët mund të udhëtonin lirshëm. Mund të studionin në universitete të huaja. Mund të ndërtonin bizneset e tyre. Mund të lexonin çdo libër. Mund të dëgjonin çdo ide. Mund të votonin. Mund të kritikonin. Mund të ëndërronin pa kufij. Këto janë fitore të mëdha. Dhe askush nuk ka të drejtë t'i nënvlerësojë. Liria nuk është një luks. Është kushti themelor i dinjitetit njerëzor.

Prandaj, çdo krahasim mes dy epokave duhet të nisë nga kjo e vërtetë.

Nuk mund të ndërtohet një shoqëri moderne pa liri. Por po aq e vërtetë është edhe diçka tjetër. Liria, e vetme, nuk mjafton. Një shoqëri nuk bëhet më humane vetëm sepse ka më shumë mundësi.

Ajo bëhet më humane kur di t'i përdorë ato mundësi për të forcuar njeriun, familjen dhe komunitetin. Kur zhvillimi ecën më shpejt se njeriu. Shqipëria ka ndryshuar me një ritëm që pak vende në Europë e kanë përjetuar. Brenda tri dekadash kemi kaluar nga mungesa e telefonit te telefoni inteligjent. Nga makina që ishte luks, te autostradat. Nga një televizion i vetëm te mijëra kanale. Nga izolimi te lëvizja e lirë. Nga ekonomia e komanduar te tregu i lirë. Ky transformim ka qenë i jashtëzakonshëm. Por çdo transformim i madh sjell edhe kosto. Kosto që nuk maten gjithmonë me shifra. Maten me boshllëqe. Me heshtje. Me mungesa. Në shumë fshatra dëgjohej vetëm zërat e të moshuarve.

Në shumë qytete apartamentet ndriçohen vetëm gjatë pushimeve, kur fëmijët kthehen nga emigracioni. Në shumë familje tavolina është më e pasur se dikur. Por rreth saj ulen më pak njerëz. Kjo nuk është vetëm një statistikë demografike. Është një ndryshim i thellë kulturor. Brezi që iku dhe brezi që kërkon rrënjët. Ka një fenomen që më duket ndër më domethënësit në Shqipërinë e sotme. Të rinjtë që nuk kanë jetuar vitet '60, '70 apo '80 janë gjithnjë e më të interesuar t'i njohin ato. Jo përmes librave të historisë. Por përmes rrëfimeve të gjyshërve.

Ata pyesin: *“Si ishte shkolla?”*, *“Si ishte lagjja?”*, *“Çfarë bënit kur nuk kishit internet?”*, *“Si festonit?”*, *“Si ishte ushtria?”*, *“Si ishte jeta?”*.

Këto pyetje nuk lindin nga nostalgia. Lindin nga nevoja për identitet.

Sepse një brez që nuk njeh rrënjët e tij, e ka më të vështirë të ndërtojë degët e së ardhmes. Prandaj rrëfimet e brezit të vjetër nuk janë thjesht kujtime. Janë një pasuri kulturore. Janë një arkiv i gjallë. Janë historia e përditshme e shqiptarëve.

Historia nuk shkruhet vetëm nga kryeministrat, gjeneralët apo akademikët. Ajo shkruhet edhe nga gjyshja që ruan ende librin e parë të nipit. Nga ushtari që mban fotografinë e repartit. Nga mësuesja që kujton klasën e parë. Nga punëtori që ende ruan kartën e punës. Këto janë dokumentet e heshtura të një kombi.

A kemi humbur aftësinë për të dëgjuar?

Jetojmë në epokën e komunikimit. Por paradoksi është se dëgjojmë gjithnjë e më pak. Çdo njeri flet. Pak njerëz dëgjojnë. Kjo është një nga arsytet pse kujtesa e brezave po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Sepse ajo na mëson durimin. Na mëson të ndalemi. Na mëson se jeta nuk matet vetëm me shpejtësinë. Por edhe me thellësinë. Shqipëria nuk ka nevojë të zgjedhë mes së djeshmes dhe së sotmes. Ajo ka nevojë të ndërtojë një urë. Një urë ku brezi që jetoi sakrificat t'i tregojë brezit që jeton lirinë se çdo e drejtë fitohet me mund. Dhe brezi që jeton sot t'i kujtojë brezit të djeshëm se liria është pasuria më e madhe që një komb mund të ketë. Vetëm atëherë kujtesa pushon së qeni nostalgji. Ajo bëhet urtësi.

Një komb nuk jeton as me nostalgji, as me harresë

Në fund të këtij udhëtimi mes dy epokave, mbetet vetëm një pyetje:

Për çfarë kemi vërtet nostalgji?

Për Shqipërinë e viteve '60, '70 e '80? Për Shqipërinë e pas viteve '90? Apo, në të vërtetë, për diçka shumë më të thellë se koha vetë? Sepse koha nuk është asnjëherë vetëm kalendar. Koha është mënyra se si jetojnë njerëzit. Është mënyra si përshëndeten në mëngjes. Si ulen në tavolinë. Si edukojnë fëmijët. Si respektojnë mësuesin. Si nderojnë uniformën. Si kujdesen për prindërit. Si mbajnë fjalën e dhënë.

Nëse do ta shihnim historinë shqiptare vetëm si përplasje sistemesh, do të bënim padrejtësi ndaj miliona njerëzve që jetuan, punuan, sakrifkuan dhe ëndërruan në secilin prej tyre. Sepse Shqipëria nuk është vetëm historia e institucioneve. Është historia e njerëzve të zakonshëm. E mësueses që kaloi jetën duke u mësuar brezave alfabetin. E mjekut që shpëtoi jetë pa pyetur për orarin. E ushtarakut që e kuptoi se uniforma nuk është privilegj, por përgjegjësi. E fermerit që mbolli tokën me bindjen se çdo stinë është një premtim. E artistit që kërkoj të mbante gjallë shpirtin e një kombi. Ata nuk jetuan për të hyrë në histori. Por pa ta, historia nuk do të ishte shkruar. Shpesh themi se Shqipëria ka ndryshuar.

Po.

Ka ndryshuar shumë. Rrugët janë më të gjera. Qytetet janë më të mëdha. Teknologjia ka hyrë në çdo shtëpi. Shqiptarët udhëtojnë, studiojnë dhe punojnë në çdo cep të botës. Forcat tona të Armatosura janë pjesë e aleancës më të fuqishme ushtarake në histori. Të rinjtë kanë horizonte që dikur dukeshin të paarrtshme. Këto janë fitore që duhen çmuar. Por ndërsa kemi ndërtuar ura, aeroporte, autostrada dhe rrjete dixhitale, lind një pyetje që nuk mund të shmanget:

A kemi ndërtuar me të njëjtin përkushtim edhe urat mes njerëzve?

Sepse zhvillimi nuk matet vetëm me prodhimin kombëtar, me investimet apo me teknologjinë.

Një komb matet edhe me mënyrën se si kujdeset për më të moshuarit. Me respektin që u jep mësuesve. Me vendin që zë libri në jetën e përditshme. Me besimin që qytetarët kanë te njëri-tjetri. Me aftësinë për të mos e lënë askënd vetëm. Këto nuk janë tregues ekonomikë. Janë tregues qytetërimi.

Prandaj nostalgia nuk duhet parë si një përpjekje për të rikthyer të kaluarën.

Ajo është një alarm i heshtur. Një kujtesë se zhvillimi material nuk mund të zëvendësojë zhvillimin shpirtëror. Se teknologjia nuk mund të zëvendësojë përqafimin. Se një rrjet social nuk mund të zëvendësojë një bisedë mes tre brezash në të njëjtën tavolinë. Se asnjë inteligjencë artificiale nuk mund të krijojë vetvetiu dashurinë, besimin dhe solidaritetin që ndërtohen vetëm mes njerëzve.

Në fund të fundit, ndoshta brezat që flasin me mall për vitet '60, '70 dhe '80 nuk kanë mall për mungesën.

Kanë mall për praninë. Për praninë e familjes. Për praninë e fqinjit. Për praninë e shokut. Për praninë e komunitetit. Dhe ndoshta brezi i sotëm nuk kërkon të jetojë në të kaluarën. Ai kërkon të kuptojë se si mund të jetojë më mirë të tashmen. Këtu qëndron edhe detyra jonë si shoqëri. Jo të ndërtojmë mite. Jo të rrëzojmë kujtime. Por të dimë të dallojmë vlerën nga ideologjia. Sepse solidariteti nuk ka ngjyrë politike. Respekti nuk i përket një sistemi. Dashuria për familjen nuk varet nga një regjim. Dinjiteti i punës nuk është pronë e asnjë epoke.

Kultura nuk lind nga propaganda. Ajo lind nga shpirti i një populli. Historia na mëson se kombet që ecin përpara nuk janë ato që harrojnë. Janë ato që dinë të kujtojnë me mençuri. Që nuk e shohin të kaluarën si strehë. Por si mësuese. Ndoshta ky është edhe kuptimi më i thellë i nostalgjisë. Ajo nuk është dëshirë për t'u kthyer pas. Është frika se mos humbasim atë që na bëri njerëz.

Shqipëria e shekullit XXI nuk ka nevojë të zgjedhë mes dy epokave. Ajo ka nevojë të ndërtojë një kulturë të re, ku liria të ecë krah për krah me përgjegjësinë; ku zhvillimi ekonomik të mos shkëputet nga drejtësia sociale; ku teknologjia të mos zëvendësojë komunikimin njerëzor; ku familja të mbetet qendra e edukimit dhe shkolla tempulli i dijes. Vetëm atëherë do të mund të themi se kemi mësuar nga historia.

Jo duke e idealizuar. Jo duke e mohuar. Por duke e kuptuar. Sepse një popull që kujton me urtësi është një popull që ecën përpara me siguri.

Dhe nëse një ditë brezat që do të vijnë pas nesh do të flasin me mall për Shqipërinë e sotme, le të mos jetë për ndërtesat që ngritëm apo për teknologjinë që përdorëm.

Le të jetë sepse arritëm të ndërtonim një vend ku njeriu respektonte njeriun.

Kombet nuk mbahen në këmbë vetëm nga ekonomia, institucionet apo ushtritë. Ato mbahen në këmbë nga kujtesa, nga karakteri dhe nga vlerat që zgjedhin të mos i humbasin kurrë.

Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse nostalgia nuk është armike e së ardhmes. Kur kuptohet drejt, ajo bëhet ura që lidh atë që kemi qenë me atë që ende mund të bëhemi.



SHOQATAT E USHTARAKËVE SHQIPTARË

Nga Fragmentarizimi drejt një Organizimi të Bashkuar në Shërbim të Ushtarakëve dhe Interesit Kombëtar

MATERIAL ORIENTUES DHE FTESE PËR DEBAT



NËNKOLONEL (R) AGIM LIQA

Ky material paraqitet si bazë orientuese për një debat të hapur, konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, me synimin për të arritur një organizim të përbashkët të shoqatave të ushtarakëve shqiptarë.

Kjo nismë është rezultat i një nevojë të kahershme të shprehur nga shumë ushtarakë në lirim, rezervë dhe pension, të cilët kërkojnë një përfaqësim më të bashkuar, më dinjitoz dhe më të fuqishëm.

Për hartimin e këtij materiali janë zhvilluar konsultime me personalitete të njohura të komunitetit ushtarak, ish-drejtuës të Forcave të Armatosura, profesorë, akademikë, studiues dhe drejtues shoqatash, mendimet dhe sugjerimet e të cilëve kanë shërbyer në ndërtimin e kësaj nisme.

Qëllimi nuk është krijimi i një organizate mbi organizatat ekzistuese, por ndërtimi i një mekanizmi bashkëpunimi që respekton identitetin, historinë dhe pavarësinë e secilës shoqatë, duke krijuar një zë të përbashkët për çështjet që prekin komunitetin e ushtarakëve.

Fragmentarizimi – një sfidë që duhet kapërcyer

Shoqatat e ushtarakëve në lirim, rezervë dhe pension përbëjnë një pasuri të rëndësishme kombëtare. Ato ruajnë traditat, kujtesën historike dhe vlerat profesionale të Forcave të Armatosura. Në Shqipëri veprojnë shoqata të ndryshme të Skënderbegasve, oficerëve në rezervë, armëve e shërbimeve, si dhe organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Megjithatë, mungesa e një koordinimi të qëndrueshëm ka bërë që këto organizata të veprojnë shpesh të ndara, duke dobësuar përfaqësimin e përbashkët. Ndërkohë, sfidat që përballojnë ushtarakët janë të njëjta: mbrojtja e të drejtave ligjore, ekonomike e sociale, trajtimi dinjitoz, kujdesi për veteranët, ruajtja e trashëgimisë historike dhe forcimi i rolit të tyre në jetën publike.

Bashkimi për interesin e përbashkët

Bashkëpunimi nuk nënkupton humbjen e identitetit të shoqatave. Përkundrazi, ai synon krijimin e një Forumi ose Federate Kombëtare që bashkërendon qëndrimet për çështjet madhore, forcon dialogun me institucionet shtetërore dhe partnerët strategjikë, si dhe i jep komunitetit ushtarak një përfaqësim më të fortë dhe më autoritar.

Forca e organizimit nuk matet me numrin e shoqatave, por me aftësinë për të vepruar së bashku në shërbim të ushtarakëve dhe të interesit kombëtar.

Misioni i organizimit të përbashkët

Organizimi i përbashkët duhet:

- të mbrojtë të drejtat ligjore, ekonomike dhe sociale të ushtarakëve;
- të ruajë dhe promovojë historinë, traditat dhe vlerat e Forcave të Armatosura;
- të jetë pjesë aktive e jetës publike dhe institucionale, duke kontribuar në çështjet

e sigurisë kombëtare, mbrojtjes së vendit, menaxhimit të emergjencave civile dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura;

- të ofrojë mendim profesional, studime, konferenca dhe rekomandime për institucionet shtetërore;
- të nxisë solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet brezave të ushtarakëve;
- të promovojë figurën dhe kontributin e ushtarakut shqiptar në shoqëri.

Parimet mbi të cilat duhet të ndërtohet organizimi

Organizimi i përbashkët duhet të mbështetet mbi:

- respektin reciprok;
- barazinë ndërmjet të gjitha shoqatave;
- transparencën në vendimmarrje;
- meritokracinë;
- konsensusin për çështjet strategjike;
- pavarësinë nga ndikimet politike;
- përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien.

Drejtimi duhet të jetë shërbim dhe përgjegjësi, jo privilegj. Organizatat kanë nevojë për drejtues me integritet moral, autoritet profesional dhe vizion bashkues.

Propozime për debat

Në funksion të arritjes së një marrëveshjeje të përbashkët, propozohen për diskutim:


- krijimi i një Forumi ose Federate Kombëtare të Shoqatave të Ushtarakëve;
- hartimi dhe miratimi i Platformës së Përbashkët të Bashkëpunimit;
- anëtarësimi vullnetar i ushtarakëve në lirim, rezervë dhe pension;
- përfshirja e të gjitha organizatave ushtarake, duke respektuar autonominë e secilës;
- krijimi i një Këshilli Koordinues me figura me integritet të lartë moral e profesional, të cilët deklarohen mungesën e përkatësisë partiake gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre;
- krijimi i një reviste ose organi informues të përbashkët;
- ndërtimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera shtetërore.

Ky material nuk është një dokument përfundimtar, por një ftesë e hapur për debat, mirëkuptim dhe bashkëpunim. Synimi është që, mbi bazën e mendimeve dhe propozimeve të të gjitha shoqatave pjesëmarrëse, të hartohet dhe të miratohet Platforma e Përbashkët e Bashkëpunimit, si dokumenti themelor i organizimit të përbashkët kombëtar të shoqatave të ushtarakëve shqiptarë.

Bashkimi nuk është qëllim në vetvete; ai është mjeti për të ndërtuar një përfaqësim më të fortë, më dinjitoz dhe më të besueshëm për çdo ushtarak shqiptar. Vetëm përmes dialogut, respektit të ndërsjellë, meritokracisë dhe unitetit mund të ndërtojmë një organizim modern, të pavarur dhe përfaqësues, në shërbim të ushtarakëve, të Forcave të Armatosura dhe të interesit kombëtar.

“NJË KARRIERË USHTARAKE, SA E BUKUR, AQ EDHE E VËSHTIRË”

LAMTUMIRË, NËNKOLONEL XHEVAHIR ABDIJA!



NGA MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Ka njerëz që largohen nga kjo jetë dhe lënë pas një boshllëk që nuk mbushet lehtë. Ka edhe njerëz që, përtej dhimbjes së familjes, lënë pas një jetë pune, shërbimi dhe kujtimeve që vazhdojnë të jetojnë te ata që i njohën.

Më 12 gusht 2026, Nënkolonel Xhevahir Abdija u përcoll për në banesën e fundit, nën praninë e familjes, bashkëshortes, fëmijëve e të afërmeve, miqve, shokëve dhe kolegëve të tij ushtarakë.

Ishte një përcjellje e dhimbshme, por edhe një ditë nderimi për një njeri që 27 vite të jetës së tij ia kushtoi uniformës, Forcave të Armatosura dhe shërbimit ndaj atdheut.

Xhevahir Abdija lindi më 30 nëntor 1962, në Sohodoll të Dibrës, në një familje atdhetare e liridashëse.

Që në moshë të re zgjodhi rrugën e ushtarakut. E nisi si “Skënderbegas”, në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, për të vijuar më pas në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në specialitetin Këmbësori, të cilën e përfundoi me rezultate të larta.

Në vitin 1985 u titullua oficer aktiv, duke nisur kështu një karrierë ushtarake që, siç e cilëson edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjenerallejtënant Arben Kingji, ishte “sa e bukur, aq edhe e vështirë”.

Formimin e tij ushtarak e thelloi më tej përmes kurseve dhe kualifikimeve të ndryshme në Akademinë e Mbrojtjes.

Karrierën e nisi si komandant toge në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Më pas vijoi në detyra pedagogjike dhe në institucionet e arsimit ushtarak, duke përcjellë te brezat e rinj jo vetëm njohuritë profesionale, por edhe përvojën dhe përgjegjësinë që mbart uniforma.



Me kalimin e viteve, detyrat e tij u rritën bashkë me përgjegjësitë.

Në vitet 2003–2005, Xhevahir Abdija shërbeu si komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake, një detyrë e rëndësishme dhe me përgjegjësi të veçantë në strukturat e Forcave të Armatosura.

Më tej, shërbeu si oficer Shtabi në Drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ku vuri në shërbim të institucionit përvojën e gjatë dhe formimin e tij profesional.

Për shërbimet e shquara, përkushtimin dhe ndershmërinë në kryerjen e detyrave, ai u vlerësua me urdhra dhe medalje të ndryshme, ndër të cilat edhe Medalja “Për Shërbime të Veçanta”, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

FJALËT E GJENERALIT PËR XHEVAHIRIN

Në telegramin e ngushëllimit drejtuar familjes, Gjenerallejtënant Arben Kingji shpreh dhimbjen për ndarjen e parakohshme të Xhevahir Abdijës dhe vlerëson rrugëtimin e tij ushtarak.

Në telegram thuhet se ai e nisi karrierën në vitin 1985 dhe se ajo ishte një karrierë “sa e bukur, aq edhe e vështirë”.

Veçohen përkushtimi dhe ndershmëria me të cilat ai kreu detyrat e ngarkuara, si dhe vlerësimet që mori gjatë shërbimit.

Por ndoshta më njerëzoret janë fjalët e fundit të telegramit, ku thuhet se me vdekjen e tij familja humbi njeriun e shtrenjtë, fëmijët dhe nipërit njeriun e tyre të dashur, ndërsa kolegët dhe shokët humbën një mik të mirë.

Dhe pikërisht këtu qëndron dhimbja e vërtetë e kësaj ndarjeje.

Sepse pas gradës, detyrës, uniformës dhe medaljeve ishte



Xhevahiri, njeriu.

Ishte bashkëshorti, babai, gjyshi, familjari, miku dhe kolegu.

MESAZH NGUSHËLLIMI NGA SHKURSH

Një mesazh ngushëllimi drejtuar familjes së Nënkolonel Xhevahir Abdijës është dërguar edhe nga Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë, Dega 4 Tiranë, me kryetar Bardhyl Fejzo, si dhe nga Presidenti i SHKURSH, Hamit Gojani.

Në këtë mesazh vlerësohet me respekt të veçantë kontributi i Xhevahir Abdijës si ushtarak aktiv dhe më pas si ushtarak në reformë, duke nënvizuar përkushtimin, profesionalizmin dhe dinjitetin me të cilin ai i shërbeu Forcave të Armatosura dhe vendit.

Ky vlerësim, i ardhur nga kolegët dhe komuniteti ushtarak, është një dëshmi tjetër se Xhevahir Abdija nuk ishte vetëm një njeri i dashur për familjen dhe miqtë, por edhe një ushtarak që la pas respekt dhe kujtim të mirë te ata që e njohën dhe shërbyen me të.

27 VITE NË UNIFORMË

Njëzet e shtatë vite nën uniformë nuk janë thjesht vite pune. Janë vite jete. Vite përgjegjësie, disipline, sakrifice, komandimi, mësimdhënieje dhe shërbimi.

Një pjesë e madhe e jetës së Xhevahir Abdijës kaloi në shërbim të Forcave të Armatosura.

Ai e nisi si “Skënderbegas”. U bë oficer. Komandoi togë. Shërbeu në arsimin ushtarak. Komandoi Batalionin e Policisë Ushtarake. Shërbeu në Shtabin e Përgjithshëm. U vlerësua me urdhra dhe medalje.

Dhe mbi të gjitha, la pas respektin e njerëzve me të cilët punoi dhe shërbeu.

BIR I NJË OFICERI DHE TRASHËGIMTAR I NJË TRADITE USHTARAKE

Xhevahir Abdija ishte bir oficeri.

Babai i tij, Selim Abdija, ishte një ushtarak i njohur, i cili shërbeu në Korpusin e Burrelit dhe më pas si Komisar i Brigadës së Peshkopisë.

Kjo trashëgimi familjare ushtarake nuk ishte thjesht një kujtim i së kaluarës, por një vlerë që Xhevahiri e mori me vete gjatë gjithë rrugëtimit të tij.

Ai e vijoi këtë traditë me përkushtim, disiplinë, ndershmëri dhe dinjitet, duke u bërë vetë një figurë e respektuar e Forcave të Armatosura shqiptare.

XHEVAHIRI QË NJOHA

Por përtej kësaj kronologjie detyrash dhe vlerësimesh, unë dua të kujtoj edhe Xhevahirin që kam njohur nga afër.

E kam njohur në jetën ushtarake, aty ku karakteri i njeriut provohet jo vetëm në zyrë, por edhe në terren.

Në stërvitjet në Feken, në kushtet e vështira të dimrit, në stërvitjet e mbijetesës, aty ku lodhja, të ftohtit dhe vështirësitë nxjerrin në pah atë që ke vërtet brenda vetes.

Aty e shihje Xhevahirin të angazhuar, këmbëngulës dhe të gatshëm të mos e linte tjetrin pas.

Ajo që më ka mbetur veçanërisht në kujtesë ishte vullneti

dhe këmbëngulja e tij për të motivuar të tjerët.

Nuk mjaftohej vetëm me kryerjen e detyrës së vet. Dinte të shtynte përpara edhe të tjerët, t'u jepte besim dhe t'i bindte se mund t'ia dilnin edhe atëherë kur kushtet ishin të vështira.

Në marrëdhëniet me vartësit dhe eprorët, dinte të ruante atë ekuilibër që nuk është i lehtë në jetën ushtarake: respektin për hierarkinë, por edhe respektin për njeriun.

Kishte tiparet e një lideri.

Jo të atij drejtuesi që imponon autoritetin vetëm përmes gradës, por të atij që e fiton autoritetin përmes sjelljes, punës dhe shembullit personal.

Ishte i thjeshtë, bashkëpunues, njerëzor dhe i qeshur. Kishte një mënyrë komunikimi të hapur dhe një sjellje që të afronte.

Në shumë aspekte, kishte një mendësi perëndimore, veçanërisht në marrëdhëniet profesionale, në bashkëpunim, në komunikim dhe në mënyrën se si e shihte njeriun brenda uniformës.

SI E KUJTOJNË MIQTË DHE KOLEGËT

Përtej detyrave, gradave dhe vlerësimeve zyrtare, Xhevahir Abdija mbetet në kujtesën e miqve dhe kolegëve si një mik dhe njeri model, që nuk harrohet kollaj. Ata që e njohën nga afër e kujtojnë si një ushtarak të zotë, një burrë të zakoneve dhe traditave kombëtare, një atdhetar të shquar dhe besnik të misionit dhe vlerave kombëtare.

Në kujtimet e tyre, ai ishte njeriu që i përballonte me dinjitet edhe situatat e vështira dhe dilemat që sillte përmbushja e misionit, duke ruajtur qetësinë, përgjegjësinë dhe integritetin e tij.

Këto vlerësime marrin një peshë të veçantë sot, kur ai nuk është më mes nesh.

Sepse gradat dhe detyrat mund të shkruhen në një biografi, medaljet mund të regjistrohen në një dosje, por respekti i njerëzve fitohet gjatë jetës.

Dhe Xhevahir Abdija e fitoi atë.

E fitoi me punën, me sjelljen, me përkushtimin, me marrëdhëniet njerëzore dhe me mënyrën se si qëndroi përballë detyrës.

Sot përcollëm për në banesën e fundit një mik, një kolegu dhe një ushtarak të zotë.

Por kujtimi për të nuk do të shuhet.

Ai do të mbetet te familja, te miqtë, te kolegët dhe te të gjithë ata që patën fatin ta njohin.

NUK PËRCILLET KUJTIMI

Më 12 gusht, familja, të afërmit, miqtë, shokët dhe kolegët ushtarakë e përcollën Xhevahir Abdijën për në banesën e fundit.

U përcoll një njeri që e mbylli rrugëtimin e tij tokësor, por nuk u përcoll kujtimi i tij.



Sepse kujtimi mbetet te familja.

Mbetet te fëmijët dhe nipërit.

Mbetet te miqtë.

Mbetet te kolegët dhe bashkëluftëtarët.

Mbetet te ata që e njohën dhe te brezat që ai ndihmoi të formoheshin.

Nga Sohodolli i Dibrës, ku nisi jeta e tij, deri te detyrat që mbajti në Forcat e Armatosura, Xhevahir Abdija la pas gjurmët e një jete të lidhur me uniformën, detyrën dhe atdheun.

Sot ai nuk është më mes nesh.

Por kujtimi i tij është.

Lamtumirë, Nënkolonel Xhevahir Abdija!

U prehsh në paqe!

Kujtimi yt qoftë i përjetshëm!

EUROPA DHE TEKNOLOGJITË E REJA TË GODITJES SË THELLË

NATO investon 50 miliardë dollarë për armët e precizionit në distancë gjatë dekadës së ardhshme

Në Samitin e NATO-s të mbajtur në Ankara, dymbëdhjetë vende aleate njoftuan një angazhim historik prej 50 miliardë dollarësh për zhvillimin e armëve të goditjes së thellë – sisteme që mund të neutralizojnë objektiva strategjikë shumë përtej vijës së frontit. Ky investim i përbashkët vjen në një moment kur fushata e Ukrainës kundër objektivave brenda territorit rus ka treguar efektivitetin e goditjeve në distancë, duke dëmtuar rreth 25% të kapaciteteve të rafinimit të naftës në Rusi dhe duke ngritur moralin e trupave ukrainase.

Ky zhvillim nuk është thjesht një reagim ndaj realitetit të luftës, por një ndryshim paradigme në mënyrën se si Europa e sheh mbrojtjen e saj. Goditja e thellë nuk është më një luks teknologjik, por një domosdoshmëri strategjike.

ELSA – Arkitektura e përbashkët europiane

Franca, Gjermania, Italia, Polonia, Suedia dhe Britania kanë krijuar *European Long-Range Strike Approach* (ELSA), një platformë bashkëpunimi që synon të harmonizojë kërkesat ushtarake dhe zhvillimet industriale. ELSA nuk është një raketë e vetme, por një strukturë koordinuese që lidh planifikimin e mbrojtjes së NATO-s me instrumentet industriale të BE-së dhe sistemet e inteligjencës europiane.

Ky projekt është i ndarë në klastra teknologjikë: paralajmërimi i hershëm, shtypja e mbrojtjes ajrore, integrimi i sensorëve dhe sistemet e lëshimit. Çdo klaster po evoluon në një grup implementimi të pavarur, duke krijuar një rrjet të integruar aftësish që mund të përdoren në mënyrë të sinkronizuar.

ELSA është shembulli më i qartë se si Europa po përpiket të ndërtojë sovranitet teknologjik në fushën e armëve të avancuara, duke mos u mbështetur vetëm te SHBA.

PrSM – raketa amerikane në shërbim të AUKUS

Britania ka blerë *Precision Strike Missile* (PrSM) nga “Lockheed Martin”, në kuadër të marrëveshjes AUKUS me Australinë. Raketa balistike, e lëshuar nga toka, ka rreze veprimi 60–500 km dhe është përdorur tashmë nga SHBA në Lindjen e Mesme.

Megjithatë, vendet europiane po kërkojnë pavarësi industriale, me MBDA që zhvillon alternativa ndaj raketave amerikane si “Tomahawk Land Attack Cruise Missile”. Ky kontrast tregon dilemat e Europës: të blejë teknologji të gatshme nga SHBA apo të investojë në zhvillimin e vet, edhe pse më i ngadalshëm dhe më i kushtueshëm.

Stratus – pasardhësi i Storm Shadow

Projekti *Stratus*, i nisur nga Britania dhe Franca, synon të zëvendësojë sistemet ekzistuese *Storm Shadow/SCALP* dhe *Exocet*. Ai përfshin dy variante:

- **Rapid Strike (RS)** – raketë supersonike për goditje të shpejtë
- **Low Observable (OS)** – raketë subsonike me fshehtësi të lartë

Italia është bashkuar në program, ndërsa Britania ka premtuar 1.4 miliardë £ për zhvillimin e tij. *Stratus* pritet të operojë deri në vitet 2060, duke ofruar variante ajrore, detare dhe tokësore.

Ky projekt është një gur themeli për industrinë europiane të raketave, duke synuar jo vetëm zëvendësimin e sistemeve të vjetra, por edhe krijimin e një platforme fleksibile që mund të përshtatet për misione të ndryshme.

Nightfall dhe Brakestop – mbështetje për Ukrainën

Britania ka kërkuar zhvillimin e raketës *Nightfall*, me rreze 600 km, për të mbushur boshllëkun e kapaciteteve të Ukrainës. Në të njëjtën kohë, projekti *Brakestop* synon prodhimin e dronëve të lirë, me efekt masiv, që arrijnë deri në 600 km. Tre kompani janë përzgjedhur: MBDA (“Crossbow”), MGI (“Tigershark”) dhe *Rotron Aerospace* (“SkyLance”).

Këto projekte tregojnë një qasje të re britanike: zhvillimi i sistemeve të shpejta, të thjeshta dhe me kosto të ulët, të përshtatshme për luftë intensive si ajo në Ukrainë.

Anglo-German Trinity House

Britania dhe Gjermania po eksplorojnë një sistem të ri



që mund të udhëtojë mbi 2,000 km, pjesë e një familjeje të ardhshme raketash hipersonike dhe *stealth* që pritet të hyjnë në shërbim në vitet 2030. Ky projekt lidhet me interesat strategjike gjermane, sidomos pasi SHBA ka anuluar dërgimin e raketave TLACM dhe *Standard Missile 6* në Berlin.

Nëse realizohet, *Trinity House* do të jetë një kapacitet unik europian, i krahasueshëm me raketat më të avancuara amerikane dhe ruse.

LCM/NCM Mk II – evolucioni francez

Në panairin “Eurosatory 2026”, MBDA prezantoi versionin e ri të raketës *Naval Cruise Missile* (McCN), që do të përshtatet për përdorim tokësor si *Land Cruise Missile* (LCM). Versioni Mk II do të funksionojë edhe në mjedise pa sinjal GNSS dhe do të ketë lëshues të dedikuar.

Ky zhvillim tregon ambicien franceze për të krijuar një familje raketash të integruara, që mund të përdoren nga deti, toka dhe ajri, duke rritur fleksibilitetin operacional.

Perspektiva teknologjike dhe strategjike

Investimi prej 50 miliardë dollarësh nuk është thjesht një shifër. Ai përfaqëson një ndryshim të madh kulturor dhe teknologjik në Europë. Nga raketat balistike te dronët me kosto të ulët, nga sistemet *stealth* te hipersonikët, kontinenti po ndërton një ekosistem të plotë armësh të goditjes së thellë.

- Ky ekosistem ka disa karakteristika kryesore:
- **Diversitet teknologjik:** nga raketat supersonike te dronët ekonomikë.
 - **Integrim multinacional:** projekte të përbashkëta si ELSA dhe *Trinity House*.
 - **Sovranitet industrial:** synimi për të mos u varur nga SHBA.
 - **Fokus në fleksibilitet:** sisteme që mund të lëshohen nga toka, ajri dhe deti.
- Në një kohë kur teknologjia e raketave po evoluon drejt hipersonikës, *stealth*-it dhe integritit të inteligjencës artificiale, Europa po përpiket të mos mbetet prapa, duke ndërtuar kapacitete që jo vetëm garantojnë siguri, por edhe rrisin ndikimin e saj global.

Europa nën flakë: Temperaturat ekstreme dhe betejat kundër zjarreve

Europa po përjeton një verë që po shënon rekorde të reja në çdo aspekt: temperatura që tejkalon 45°C, pyje që digjen pa kontroll dhe qytete që përballen me mungesë uji e ajër të rënduar nga tymi. Nga Mesdheu deri në Skandinavi, kontinenti është kthyer në një hartë të kuqe alarmi, ku çdo ditë sjell lajme për vatra të reja zjarri dhe përpjekje titanike për t'i shuar ato.

Rekorde të nxehtësisë që sfidojnë klimën

Në Spanjë, Portugali dhe Itali, termometri ka kapur shifra që deri pak vite më parë konsideroheshin të pamundura. Në Sevilje, temperatura arriti 47°C, ndërsa në Sardenjë u regjistruan 46.5°C – vlera që kanë tejkaluar kufijtë e sigurisë për njerëzit dhe ekosistemet.

Në Francë, qeveria ka shpallur gjendjen e emergjencës klimatike në disa rajone jugore, ku reshjet mungojnë prej javësh dhe erërat e nxehta nga Afrika e Veriut kanë përshpejtuar përhapjen e flakëve.

Meteorologët paralajmërojnë se ky valë e nxehtë nuk është një fenomen i izoluar, por pjesë e një tendence afatgjatë që po e zhvendos klimën europiane drejt kushteve subtropikale.

Zjarret që nuk njohin kufij

Në Greqi, flakët kanë përfshirë rajonet e Atikës dhe Peloponezit, duke detyruar mijëra banorë të evakohen. Pamjet nga ishulli Evia kujtojnë skenat e vitit 2021, kur vendi humbi mbi 200 mijë hektarë pyje.

Në Itali, rajonet e Sicilisë dhe Kalabrisë janë nën presion të vazhdueshëm, ndërsa brigadat e zjarrfikësve punojnë pa pushim në terrene të vështira.

Në Francë, rajoni Gironde – i njohur për vreshtat e tij – është shndërruar në një zonë të djegur, ku tymi ka mbuluar qiellin për ditë të tëra.

Zjarret nuk janë më vetëm një problem mesdhetar. Edhe vendet veriore si Gjermania, Polonia dhe Suedia po raportojnë vatra të reja, të nxitura nga thatësira e zgjatur dhe temperaturat e pazakonta për këto gjerësi gjeografike.

Teknologjia në shërbim të shpëtimit

Europa po përpaket të përballojë këtë krizë me teknologji të avancuara. Dronë me sensorë termikë patrollojnë zonat e rrezikuara, duke identifikuar vatrat e reja në kohë reale.

Sistemet satelitore të Agjencisë Hapësinore Europiane (ESA) monitorojnë përhapjen e flakëve dhe ndihmojnë në koordinimin e operacioneve ndërkuftare.

Në Itali dhe Spanjë, avionët “Canadair” janë bërë simbol i rezistencës ndaj zjarreve, ndërsa Franca ka prezantuar një flotë të re avionësh me kapacitet më të madh për hedhjen e ujit.

Por ekspertët paralajmërojnë se teknologjia nuk mjafton. “Ne mund të shohim zjarrin nga qielli, por nuk mund ta ndalojmë pa ndryshuar mënyrën si jetojmë”, - tha një zyrtar i mbrojtjes civile franceze.

Ndikimi në mjedis dhe ekonomi

Pasojat janë dramatike. Pyjet e djegura po humbasin aftësinë për të thithur dioksid karboni, duke përkeqësuar më tej efektin serë.

Turizmi, një nga sektorët më të rëndësishëm të Europës jugore, po pëson goditje të forta. Hotele në Greqi dhe Itali raportojnë anulime masive, ndërsa fermerët në Spanjë po humbasin të korrat për shkak të thatësirës ekstreme.

Në Portugali, qeveria ka paralajmëruar se dëmet ekonomike nga zjarret e këtij viti mund të kalojnë 1 miliard euro. Ndërkohë, në Francë, autoritetet po përgatiten për një krizë të re energjetike, pasi temperaturat e larta po ndikojnë në funksionimin e centraleve bërthamore që përdorin ujë për ftohje.

Shkenca pas flakëve

Sipas studiuesve të Qendrës Europiane për Parashikimet Afatgjata, kombinimi i El Niño, ngrohjes globale dhe ndryshimeve në qarkullimin atmosferik ka krijuar një “koktejl klimatik” që favorizon zjarret.

Në disa zona, lagështia e tokës ka rënë në nivele të krahaseshme me shkretëtirat, ndërsa bimësia e tharë është bërë karburant natyror për flakët.

Kjo situatë ka nxitur kërkime të reja për materiale rezistente ndaj nxehtësisë, për sisteme automatike të parandalimit të zjarreve dhe për algoritme të inteligjencës artificiale që parashikojnë rrezikun bazuar në temperaturë, lagështi dhe erë.



Solidariteti europian

Nën presionin e krizës, vendet e BE-së po forcojnë bashkëpunimin për mbrojtjen civile.

Programi RescEU ka aktivizuar flotën e përbashkët të avionëve zjarrfikës, ndërsa qindra specialistë nga Gjermania, Polonia dhe Çekia janë dërguar në Greqi dhe Itali për të ndihmuar në terren.

Ky solidaritet po shihet si një provë e rëndësishme për aftësinë e Europës për të reaguar si një trup i vetëm përballë emergjencave klimatike.

Mësimet e një vere që nuk harrohet

Ekspertët thonë se vera e vitit 2026 do të mbetet një pikë kthese për politikën klimatike europiane.

Në Bruksel, Komisioni Europian po përgatit një paketë të re ligjore për menaxhimin e pyjeve dhe parandalimin e zjarreve, që do të përfshijë fonde për ripyllëzimin dhe për sistemet e vëzhgimit satelitor.

Por për shumë qytetarë, mësimi më i madh është personal: nxehtësia dhe flakët nuk janë më lajme të largëta, por realitet i përditshëm. Europa po digjet, jo vetëm nga zjarret, por edhe nga urgjenca për të ndryshuar.

Nëse ky kontinent do të arrijë të përballojë valët e nxehtësisë dhe të mbrojë mjedisin e tij, do të varet nga aftësia për të bashkuar teknologjinë, politikën dhe ndërgjegjen qytetare në një strategji të vetme për mbijetesë.

Valët e nxehtësisë që kanë përfshirë Europën këtë verë nuk kanë kursyer as Ballkanin. Nga Shqipëria deri në Kroaci, rajoni po përballët me një kombinim të rrezikshëm: temperatura rekord, thatësira të zgjatura dhe vatra zjarri që përhapen me shpejtësi në terrene malore e pyjore.

Në Shqipëri, temperaturat kanë kaluar 43°C në disa zona të jugut, ndërsa në veri, pyjet e Pukës, Dibrës dhe Tropojës janë përfshirë nga flakët për ditë të tëra. Njësitë e emergjencës civile, të ndihmuara nga forcat e ushtrisë, po punojnë pa ndërprerje për të izoluar vatrat, por terreni i vështirë dhe era e fortë e bëjnë çdo përpjekje të rrezikshme.

Në Kosovë, zjarret në rajonin e Dukagjinit kanë shkakuar dëme të mëdha në sipërfaqe pyjore, ndërsa autoritetet kanë kërkuar ndihmë nga vendet fqinje për avionë zjarrfikës. Në Maqedoninë e Veriut, rajoni i Berovës dhe Maleshevēs është shpallur zonë e rrezikut të lartë, me temperatura që kanë arritur 44°C dhe mungesë të plotë reshjesh për më shumë se një muaj.

Një rajon që digjet çdo verë më shumë

Ballkani, me klimën e tij kontinentale dhe mesdhetare, po bëhet gjithnjë e më i prekshëm ndaj ndryshimeve klimatike.

Pyjet e dendur, që dikur ishin mburojë natyrore, sot janë kthyer në karburant për flakët.

Në Mal të Zi, rajonet bregdetare si Budva dhe Bar janë përfshirë nga zjarre që kanë detyruar evakuimin e turistëve. Në Kroaci, autoritetet kanë mbyllur disa rrugë malore në Dalmaci për shkak të tymit të dendur, ndërsa në Bosnje, zjarret pranë Mostarit kanë rrezikuar linjat e energjisë elektrike. Ekspertët paralajmërojnë se rajoni po përjeton një ndryshim të shpejtë ekologjik, ku periudhat e lagështa po shkurtohen dhe stinët e thata po zgjasin më shumë. Kjo e bën çdo verë më të rrezikshme se e mëparshme.

Vendet e Ballkanit po përpiqen të forcojnë bashkëpunimin rajonal për menaxhimin e emergjencave.

Në kuadër të mekanizmit të RescEU, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë marrë mbështetje nga BE për trajnimin e ekipeve zjarrfikëse dhe për pajisje moderne.

Shkenca dhe parashikimet

Instituti Hidrometeorologjik i Ballkanit paralajmëron se valët e nxehtësisë do të bëhen më të shpeshta dhe më të gjata.

Sipas studimeve të fundit, rajoni po ngrohet me një ritëm 1.5 herë më të shpejtë se mesatarja globale.

Kjo do të thotë se, nëse nuk merren masa të menjëhershme për menaxhimin e pyjeve dhe ruajtjen e burimeve ujore, Ballkani mund të përballët me verëra që tejkalojnë 50°C brenda dy dekadave të ardhshme.

Çfarë mund të bëhet?

Ekspertët propozojnë një qasje të re rajonale:

- Menaxhim i integruar i pyjeve, me sistemet e vëzhgimit satelitor dhe patrullime të përbashkëta.
- Investime në teknologji zjarrfikëse, si dronë termikë dhe avionë të vegjël për terrene malore.
- Fushata ndërgjegjësimi për banorët lokalë mbi parandalimin e zjarreve.
- Koordinim rajonal për emergjencat, me qendra të përbashkëta reagimi.

Një verë që paralajmëron të ardhmen

Ballkani, si pjesë e Europës juglindore, po bëhet një laborator i gjallë i krizës klimatike.

Flakët që përfshijnë pyjet, thatësira që shpëtojnë lumenjtë dhe nxehtësia që mbulon qytetet nuk janë më fenomene të përkohshme – janë realiteti i ri.

Nëse rajoni nuk arrin të ndërtojë një strategji të përbashkët për mbrojtjen e mjedisit dhe përballimin e temperaturave ekstreme, verërat e ardhshme mund të jenë jo vetëm më të nxehta, por edhe më shkatërruese.



BËHU OFICER I RI I FORCAVE TË ARMATOSURA!

Ke përfunduar studimet Bachelor dhe dëshiron të ndërtosh një karrierë në uniformë?
Ky është momenti yt!

Qendra e Personel Rekrutimit hap aplikimet për vitin akademik 2026–2027, për ndjekjen e Kursit të Përgatitjes së Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura, duke ofruar 40 kuota studimi në profile të ndryshme profesionale.

Profilet e studimit:

3 KUOTA – Ndërlidhje (IT)
8 KUOTA – Logjistikë (Ekonomik, Financë, Menaxhim)
8 KUOTA – Inxhinieri (Gjeodezi, Mekanikë, Transport)
2 KUOTA – Xhenio/Infrastrukturë (Inxhinieri Ndërtimi)
2 KUOTA – Mjekësi e Përgjithshme
3 KUOTA – Navigim Detar
2 KUOTA – Kimi
2 KUOTA – Artileri Tokësore (Matematikë, Fizikë)
10 KUOTA – Këmbësori, Polici Ushtarakë, Zbulim, Personel, Drejtësi dhe profile të tjera Bachelor

AFATI I APLIKIMIT: **deri më 31 Gusht 2026**

Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura dhe kontribuo me profesionalizmin, dijen dhe përkushtimin tënd në shërbim të vendit.

Për më shumë informacion dhe kriteret e aplikimit klikoni këtu:

<https://www.mod.gov.al/.../stude.../7934-2026-08-04-09-33-03>